

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.6 (372)

QERSHOR 2019

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

DITËLINDJA



Gjeneral Parllaku, legjendë e qëndresës për liri

Limos DIZDARI & Ervin DODA FAQE 7

HISTORIA



MËSYMJA E PËRGJITHSHME PRANVERORE DHE BRIGADA E 15-TË S

Ing. Myfit Guxholli

FAQE 2

IN MEMORIAM



FAMILJA GABAJ I DHA ATDHEUT KATËR DËSHMORË

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj FAQE 5

Valët e lirisë që nuk u shuan kurrë në Kosovë, në vitin 1999 sollën përmbushjen e ëndrrës shekullore kombëtare të lirisë së Kosovës

VULLKANI I LIRISË

Askush nuk mund të çënojë vlerat e LANÇ-it

Halil RAMA

“Askush nuk mund të ketë sukses duke çënuar vlerat e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare”. Ky ka qenë mesazhi që përcolli Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta në ceremoninë përkujtimore të 76-vjetorit të themelimit të Batalionit partizan “Dumrea”, më 17 Maj 2019. Kreu i Shtetit theksoi domosdoshmërinë për të shtuar përpjekjet dhe bashkëpunimin me njëri-tjetrin, që jo vetëm të nderojmë sakrificat e heronjve tanë dhe të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, por edhe njëkohësisht të bëjmë më të mirën për vendin tonë, për integrimin europian të tij, në mënyrë që fëmijët e Cërrikut, fëmijët e Elbasanit, fëmijët e të gjithë Shqipërisë të rriten jo vetëm me mirënjohjen për të parët e tyre, por njëkohësisht edhe me ndjenjat patriotike, me dashurinë, për të bërë më të mirën për Atdheun tonë, pikërisht këtu në Cërrik, në Elbasan dhe në Shqipëri.

Më tej, presidenti Meta vlerësoi Batalionin partizan “Dumrea” si njërin nga më të lavdishmit e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, që pak kohë pas krijimit të tij, mori pjesë në njërin nga betejat më të përgjakshme të të gjithë historisë së Luftës, – atë të Pojskës. Po ashtu ai vlerësoi për kontributin e jashtëzakonshëm që dhanë partizanet dhe partizanët e këtij Batalioni për çlirimin e vendit tonë, aq më tepër tani në prag të 75-vjetorit të çlirimit të Atdheut.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, Kryetari i Bashkisë së Cërrikut, Altin Toska, autoritetet vendore, ish-partizanë dhe partizane, të afërm të dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare si dhe banorë të zonës.

VËJON NE FAQEN 3



- *Valët e këtij vullkani vazhdojnë të lëkundin edhe sot trojet iliro - arbnore të Kosovës Lindore (Lugina e Preshevës, Medvegjë, Bujanovc), Kosovës Veriore (Sanxhak), Iliriadën, Çamërinë dhe trojet e Malësisë së Tuzit e Ulqinit, të cilat rezistojnë, qëndrojnë e do të ftojnë.*

Nga Ing. Kol Dedaj

FAQE 10

URIMI

VETERANËT E OBVL, SI TË GJITHË SHQIPTARËT UROJNË ARBA KOKALARIN: SHQIPËRIA NË EUROPE



Mbesa e Musine Kokalarit, eurodeputetja e parë shqiptare

FAQE 12

FESTA

Brigada e 12-të Sulmuese la në altarin lirisë 105 dëshmorë



FAQE 4

PROFIL

MUSA REXHEP HIDA, DËSHMOR I ATDHEUT I BATALIONIT TË TRETË TË Brigadës së III-të S

FAQE 6

KOMENT

DIALOGU PRISHTINË - BEOGRAD NË RRUGË PA KRYE

Bashkim Hisari FAQE 8

HISTORIA

Çeta Partizane e Dibrës dhe aksionet e saj luftarake

Nga Sakip CAMI FAQE 9

LIBRI

DASHURIA PA LIRI MBETET FATPRERË

Rreth librit me poezi “Shqetësim zhgënjimi” të autorit Muharrem Kurti

SHPENDI TOPOLLAJ FAQE 11

HISTORIA

Mësymja e përgjithshme pranverore dhe Brigada e 15-të S

Nga Myfit GUXHOLLI

Mbështetur në traditat luftarake të popullit shqiptar, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër okupatorëve nazifashistë gjatë Luftës së Dytë Botërore mori përmasa të gjera. Njësitë e organizara të Ushtrisë NCCl dhanë një kontribut të madh në raport me numrin e popullsisë, duke e renditur popullin tonë në krahun e fitimtarëve.

Idealet e Konferencës së Pezës ishin përhapur e përqafuar kudo si ideale të bashkimit kombëtar. Me parullën “pa dalim feje, krahine dhe ideje” u lind, u forcua dhe u zhvillua lufta Nacionalçlirimtare në emër të kombit e të popullit shqiptar. Nga ky këndvështrim, lavdia e Pezës është sa heroike, aq edhe objekt për t’u studjuar si iniciuese e idealeve kombëtare.

Idealet e Pezës u shtrinë në të gjithë vendin. Rezultati është i qartë: nga njësitet në çeta e batalione...Lufta partizane mori përpjestime të gjëra duke shkuar te krijimi i njërive të mëdha të organizuara, siç qenë brigadat sulmuese.

Populli iu përgjigj thirrjes së Shtabit të Përgjithshëm të UNÇl për një mësymje të përgjithshme që të përballonte Operacionin Armik të Qershorit 1944.

Më 28 Maj 1944 formohet Divizioni i I-rë S që është një mbështetje dhe provë e gjallë e zbatimit të strategjive ushtarake të luftës së armatosur për fuqizimin e UNÇl. Shtabi i Përgjithshëm shfrytëzoi me mjeshtri formimin e reparteve të reja, brigadave dhe divizioneve, veçanërisht Divizionin e I-rë me përbërje nga tre brigada (1, 4 dhe 5), forcat tjera nëpër rrethe e komandat e vendit. Divizioni i I-rë S, më 26 Qershor 1944 kalon lumin Shkumbin dhe me luftim mësymës u goditën forcat armike gjermane, mësymje të cilën ato nuk e prisnin. Me këtë organizim synohet çlirimi i zonës së Çermenikës, rrethet e Tiranës, Dibrës e Matit, riorganizimi i këshillave Nacionalçlirimtare dhe mobilizimi i popullit për të mbështetur dhe ripërtërirë njësitë që ishin dëmtuar...

Në një kohë kur në Shqipërinë e Jugut kishte shpërthyer Operacioni Armik i Qershorit dhe kur në shumë krahina të tjera zhvilloheshin luftime të rrepta, ne



• Që nga formimi dhe deri në çlirimin e plotë të atdheut Brigada e XV-të u kompletua dhe u rrit numerikisht. Ajo arriti suksese të mëdha në të gjitha luftimet drejtpërdrejt me armikun dhe u shndërrua në një njësi të vërtetë luftarake, duke fituar admirimin e popullit të qarkut të Korçës dhe mbarë vendit. Ajo shkroi në historinë e saj një varg suksesesh, duke i shkaktuar armikut dëme të mëdha si në njerëz dhe materiale e teknikë luftarake: Mbi 500 ushtarë të vrarë, shumë armë e municione, topa, mitraloza, pushkë e material të tjera, makina të djegura, etj

Malësinë e Oparit, në fshatin Protopapë, më 29 Qershor 1944, u inaugurua Brigada e XV-të Sulmuese e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kjo brigadë e re nuk pati shumë kohë që të festonte inaugurimin e saj. Mjaftuan katër-pesë orë për organizimin e saj dhe forcat e saj u nisën menjëherë për luftë.

Brigada e XV-të S u formua nga kuadro e partizanë të batalioneve territoriale të qarkut të Korçës: “Fuat Babani”, “Hakmarrja”, “Reshit Çollaku”, “Skënder Çaçi”, “Tomorri”,

Batalioni i Rinisë dhe partizane e par-

tizanë të porsaardhur nga organizatat e terrenit, që duke ju përgjigjur organeve të pushtetit popullor të krijuara në zonat e çliruara shtuan radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare për çlirimin përfundimtar të atdheut.

I pari luftim në shkallë të gjerë i brigadës ishte goditja e forcave naziste gjermane e kolaboracioniste mbi Pogradec. Armiku, megjithëse i armatosur mirë dhe i mbrojtur në llogore e qendra zjarri, nuk mundi t’i rezistonte sulmit të shpejtë dhe të befasishtëm të partizanëve. Pozicionet me rëndësi, si kalaja dhe ana perëndimore e qytetit, Gështenjat, u morën menjëherë nga partizanët dhe forcat armike u larguan duke lënë të vrarë rreth 20 ushtarë.

Më 24 gusht 1944, një autokolonë gjermane që kalonte nga Struga për në Elbasan u sulmua nga partizanët, duke i shkaktuar dëme të mëdha në njerëz dhe materiale luftarake. U dogjën 20 makina luftarake nga batalioni i IV-t i Brigadës.

Po atë ditë, një autokolonë tjetër që vinte nga Struga në drejtim të Elbasanit u sulmua egërsisht nga forcat e Brigadës. Kjo pritë dhe goditjet u krye mbi Qukës. Këtu armiku la mbi 15 ushtarë të vrarë, ndërsa nga partizanët pati vetëm tre të plagosur. Më 30 gusht 1944 forcat e kësaj brigade çliruan Pogradecin dhe të gjithë fshatrat përreth rrugës automobilistike nga Elini në Pogradec (Pogradec-Korçë).

Natën e 24 shtatorit, forcat e batalione-

ve të dytë dhe të tretë goditën një autokolonë tjetër prej 75 makinash luftarake që vinte në drejtimin Strugë-Pogradec, duke i djegur e shkatërruar. Armikut iu kap edhe një sasi e madhe armësh dhe municionesh. Humbjet e armikut qenë të mëdha.

Brigada e XV-të, pasi kaloi lumin Shkumbin u vendos në rajonin e Elbasanit, ku zhvilloi një sërë goditjesh të ashpra kundër forcave që mbanin të pushtuar qytetin. Këto goditje synonin çlirimin e qytetit ku ndodheshin rreth 2000 ushtarë e oficerë gjermanë të armatosur me një teknikë shumë të mirë luftarake. Më pas forcat e kësaj brigade filluan mësymjen për çlirimin përfundimtar të Elbasanit. Objektivat kryesor ishin: Ura e Zaranikës, Lagja e Kishës dhe gazerat e Krastës.

Batalioni i katërt do të ruante krahët dhe njëkohësisht do të sulmonte forcat armike që ishin dislokuar në Xibrakë dhe Labinot. Batalionit të dytë i ishte ngarkuar detyra të ndërpriste rrugën Elbasan-Tiranë. Mësymja filloi që me 5 Nëntor. Pas dy ditë luftimesh, batalioni i katërt me sulme e kundërsulme mundi të thyejë rezistencën e forcave armike dhe me luftim ndeshës mori këto dy qendra të fortifikuara të Zibrakës dhe Labinotit. Njëkohësisht forcat e batalioneve të parë e të tretë, në zbatim të Urdhërit të Shtabit të Brigadës filluan luftimet për rrethimin dhe asgjësimin e forcave armike në qytet. Veprimet luftarake të të dy batalioneve gjatë sulmit dhe në rrethimin e qytetit qenë të suksesshme, megjithëse forcat armike u vedosën në qendra të forta, si ajo në Shkollën Normale dhe pika të tjera.

Mbas sulmeve të njëpasnjëshme të forcave partizane armiku nuk mundi të rezistonte dhe me humbje të mëdha u detyrua të largohet në drejtim të Tiranës dhe Rrogozhinës-Durrës.

Gjatë rrugës forcat armike iu nënshtruan goditjeve të tjera nga forcat partizane. Mbas të gjitha këtyre luftimeve të suksesshme partizanët e Brigadës XV-të S zbatuan detyrat e ngarkuara dhe më 12 Nëntor 1944 Elbasani u çlirua.

Që nga formimi dhe deri në çlirimin e plotë të atdheut Brigada e XV-të u kompletua dhe u rrit numerikisht. Ajo arriti suksese të mëdha në të gjitha luftimet drejt për drejt me armikun dhe u shndërrua në një njësi të vërtetë luftarake, duke fituar admirimin e popullit të qarkut të Korçës dhe mbarë vendit. Ajo shkroi në historinë e saj një varg suksesesh, duke i shkaktuar armikut dëme të mëdha si në njerëz dhe materiale e teknikë luftarake: Mbi 500 ushtarë të vrarë, shumë armë e municione, topa, mitraloza, pushkë e materiale të tjera, makina të djegura etj.

Më vonë Brigada e XV-të S kreu me nder detyrat luftarake që i ngarkoi Shtabi i Përgjithshëm deri në çlirimin e plotë të atdheut. Nga Brigada e XV-të S, për çlirimin e atdheut ranë dëshmorë 50 partizanë e partizane, katër kuadro dhe dy shoqe partizane: Thomadha Laçka (Tomka) dhe Shanko Starja, Istref Maka, Kiço Boboshtica, Minash Gjoka dhe Rahman Beragozhdi, ndërsa u plagosën 73 partizanë e kuadro.



MESAZHI

Presidenti Meta përshëndet 76-vjetorin e themelimit të Batalionit Partizan “Dumrea”

Askush nuk mund të ketë sukses duke cënuar vlerat e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare

- *“Ne jemi krenarë, jo vetëm se vendi ynë, u çlirua vetë, pa pasur nevojë për ndihmën e Ushtrisë së Kuqe apo forcave të tjera, por njëkohësisht sepse e ndoqëm pushtuesin deri në thellësi të ish-Jugosllavisë duke dhënë një kontribut të çmuar për çlirimin e të gjithë Europës”*

(vijon nga fq.1)

Pasi vendosi një kurorë me lule në lapidarin kushtuar ngjarjes historike në nderim të të rënëve gjatë luftës heroike për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë dhe nazistë, Presidenti i Republikës përshëndeti të pranishmit duke u shprehur: “Më 9 maj, ne festuam si gjithë Europa, Ditën e Fitores mbi Fashizmin dhe Ditën e Europës.

E theksoj këtë, sepse vendi ynë për fat të keq, ishte një prej viktimave të para të fashizmit më 7 prill 1939. Megjithatë Shqipëria e nisi betejën kundër fashizmit pikërisht më 7 prill me qëndresën e Mujo Ulqinakut me shokë, për ta vazhduar deri më 9 maj të vitit 1945.

Ne jemi krenarë, jo vetëm se vendi ynë, u çlirua vetë, pa pasur nevojë për ndihmën e Ushtrisë së Kuqe apo forcave të tjera, por njëkohësisht sepse e ndoqëm pushtuesin deri në thellësi të ish-Jugosllavisë duke dhënë një kontribut të çmuar për çlirimin e



të gjithë Europës.

Ne nuk e patëm fatin që të bëheshim pjesë e atij projekti europian, që nisi pikërisht më 9 maj 1945, pikërisht atë ditë të triumfit të lirisë mbi shtypjen dhe mbi fashizmin.

Por absolutisht ndihemi krenarë, sepse Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare është periudha më e ndritur e popullit dhe e kombit tonë, së bashku me periudhën e Skënderbeut e Ril-



indjes Kombëtare që solli pavarësinë e Shqipërisë.

Ne jemi shumë mirënjohës për sakrificat e jashtëzakonshme të bëra nga partizanët dhe partizanet e Shqipërisë, që janë të shenjta për të gjithë shqiptarët, të cilët e duan Atdheun, e duan lirinë dhe përparimin e vendit të tyre si qytetarë, me krenari dhe me dinjitet. Ndaj askush nuk mund të ketë sukses duke cënua vlerat e Luftës Anti-

fashiste Nacional-Çlirimtare, sepse ato janë kaq të forta e të larta, sa që kushdo që sulmon ato vlera, thjesht tregon dëshpërimin e tij.

Nuk është koha për t'u marrë me të kaluarën, sepse shqiptarët në atë periudhë e bënë detyrën e tyre me dinjitet dhe me sakrificat të panumërta. U vendosën në anën e duhur të historisë. Na ndihmuan edhe ne, që sot jemi në anën e duhur të historisë”.

Forcat speciale nga tre vende në stërvitjen “Joni 19”

Forcat speciale të Shqipërisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut, për rreth dy javë, u stërvitën bashkërisht në Bazën Detare të Pashalimanit.

Efektivët specialë nga tre vendet, u stërvitën për operacionet ujore, duke praktikuar tema të ndryshme si zhytjet në grup, ecjet nënujore, zhytja në thellësi në kushtet e shikueshmërisë së kufizuar, mësimja nga një mjet lundrues në një tjetër, e shumë e elementë të tjerë.

Përveç praktikës së elementëve të rinj stërvitorë dhe testimit të atyre ekzistues, rëndësi e veçantë iu dha ndërveprimit dhe bashkëpunimit të trupave nga vende të ndryshme, në një mjedis operacional shumëkombësh.

Në përfundim të stërvitjes dyjavore të koduar “Joni 19”, u zhvillua edhe Dita e Vizitorëve të Shquar, ku morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai dhe komandantët e batalioneve speciale të tre vendeve pjesëmarrëse në stërvitje.



Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka: “Shqipëria nuk është vetëm një shtyllë stabiliteti në rajonin tonë, por është eksportues i siguri”

Mbahet në Tiranë Takimi i Komitetit të Inteligjencës Ushtarake të NATO

Në kuadrin e kryesimit të Komitetit të Inteligjencës Ushtarake (MIC) të NATO nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për vitin 2019, në datat 22 - 23 maj 2019, në Tiranë, Shqipëri, u mbajt një nga dy takimet vjetore të këtij komiteti. Takimi u bashkëdrejtua nga kolonel Bardhyl Nuredinaj, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe z. Freytag von Loringhoven, ndihmësekretari i Përgjithshëm për Inteligjencën dhe Sigurinë dhe kreu i Divizionit të Përbashkët të Inteligjencës dhe Sigurisë të NATO.

Vendet anëtare të NATO dhe aktorët kyç përgjegjës për Inteligjencën u takuan për të diskutuar çështjet më kryesore të Inteligjencës. Pjesëmarrës në këtë takim ishin drejtues të agjencive dhe shërbimeve të inteligjencës ushtarake të vendeve anëtare të NATO-s, drejtues të strukturave të inteligjencës ushtarake të NATO-s, drejtues komandash operacionale, si dhe drejtues të shërbimeve të inteligjencës ushtarake të vendeve jo anëtare të NATO-s, partnerë operacionalë të saj.

Takimi u përshëndet nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila theksoi se sot, Shqipëria nuk është vetëm një shtyllë stabiliteti në rajonin tonë, por



është eksportues i siguri.

“Inteligjenca ka qenë gjithmonë shumë e rëndësishme për përpjekjet tona për sigurinë kolektive. Jetojmë në kohë sfidash dhe sot bashkimi i përpjekjeve është më i rëndësishëm se kurrë”, - tha ministrja Xhaçka.

Komiteti të Inteligjencës Ushtarake është organizmi kryesor këshillues në çështjet e inteligjencës për Komitetin Ushtarak dhe Këshillin e Atlantikut të Veriut. MIC vepron si një forum vendimmarrës për çështjet e inteligjencës me interes të përbashkët, merr pjesë aktive në formulimin dhe miratimin e politikës së inteligjencës së NATO-s, si dhe kon-

tribuon në prodhimin e Inteligjencës së Dakordësuar dhe Inteligjencës së Padakordësuar të NATO-s.

Në mjedisin gjithnjë në ndryshim të siguri, NATO përballet me shumë sfida të dimensionit të Inteligjencës. Rrjedhimisht, Alenaca dhe vendet anëtare kanë zbatuar një qasje më të koordinuar për analizën e inteligjencës dhe shkëmbimin e inteligjencës. Një inteligjencë e mirë ndihmon NATO-n të mbrojë jetë dhe të parandalojë konflikte.

Takimi i dytë për këtë vit i Komitetit të Inteligjencës Ushtarake do të mbahet në nëntor 2019 në selinë e NATO-s, Bruksel.

FESTA

Në Sukë të Dëshnicës u festua me madhështi 75 - vjetori i krijimit të Br. 12 Sulmuese

Brigada e 12-të Sulmuese la në altarin lirisë 105 dëshmorë



Më 20 Maj 2019 u përkujtua 75 – Vjetori i krijimit të Brigadës së 12-të S. Ambient festiv, flamuj e banderola, kurora dhe tufa me lule këngë dhe marshe partizane pranë lapidarit të kësaj brigade.

Nderuan me pjesëmarjen e tyre, kryetari bashkisë Këlcyre z. Klement Ndoni, kryetari Këshillit të Qarkut Gjirokastrë z. Armand Hilaj, ish deputeti dhe djali i komisarit të brigadës z. Fatos Klosi, kryetarja e familjes së dëshmorëve znj. Flora Hoxha, kryetari dhe sekretari i FD z. Bujar Sula e Krenar Progonati etj.

Kishin ardhur veteranë, miq dhe të afërm të tyre nga Permeti, Suka e Ballabani, pasardhësit e veteranëve dhe të familjeve të dëshmorëve Tepelenë dhe nxënësit e shkollës së mesme “Lumo Pavari” Sukë me mësuesit dhe drejtorin e shkollës z. Agron Mehmeti, të cilët i dhanë gjallëri të veçantë këtij manifestimi.

Pranë lapidarit u vendosën kurora në emër të bashkisë dhe organizatave të veteranëve e të Familjeve të dëshmorëve. Nën tingujt e himnit kombëtar u mbajt një minutë heshtje në nderim të të rënëve dhe sakrificave të kuadrove dhe partizaneve të kësaj njësie.

Përsëritet në emër të bashkisë dhe të këshillit bashkiak nënkryetari Riza Allamani i cili bëri një ekspozitë të gjerë të rrugës luftarake të Br.12 Sulmuese.

Z. Armand Hilaj përshëndeti në emër të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe lexoi përshëndetjen e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë z. Gramoz Ruçi, drejtuar pjesëmarësve në këtë festë jubilarë.

Nxënësit e Shkolles “Lumo Pavari” kishin përgatitur një recital poetik. Mitingun e mbylli Kryetari Bashkisë z. Klement Ndoni dhe ftoi të pranishmit në një drekë, ku vazhdoi bashkëbisedimi, u sollën kujtime, u kënduan këngë, u pinë dolli te cilat kaluan gëzueshëm dhe u ndamë me urimin, mirupafshimin në 24 Maj në Permet dhe në përvjetorë të tjerë në vitin e 75 – vjetorit të çlirimit të Atdheut.

Brigada e 12 Sulmuese u krijua në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Ishte maj i vitit 1944, kur partizanët shqiptarë po vulosnin me betejat dhe gjakun e tyre fitoren e kësaj lufte çlirimtare, antifashiste, patriotike dhe emancipuese për

Shqipërinë dhe kombet e qytetëruara.

Ishte 20 maji 1944, kur 600 partizanë e partizane të ardhur nga Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë, në Sukë krijuan Brigadën e 12, nën drejtimin e Komandantit Refat Bajrami dhe Komisarit Qemal Klosi, dy personalitete të shquar të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare.

Brigada e 12 ka shumë merita lufte, trimërie dhe heroizmi. Por kjo Brigadë ka edhe një meritë të veçantë, që e dallon nga formacionet e tjera të Ushtrisë partizane: numrin shumë të madh të vajzave luftëtare. Rreth 200 vajza ose 30 përqind e luftëtarëve të Brigadës ishin vajza.

Kjo rrethanë zbulon një tipar tjetër të vlerave antifashiste: lidhjen e tyre me vlerat shoqërore dhe kulturore emancipuese. Antifashizmi nuk ishte vetëm çlirimi prej pushtuesve nazistë e fashistë, por hapi rrugën për progres

të gjithanshëm politik, shoqëror e kulturor në gjithë botën e qytetëruar.

Prej këtij progresi nuk përfituan vetëm kombet fituese, por të gjitha kombet, të gjithë vendet dhe të gjithë popujt.

Brigada e 12 ka një bilanc të pasur betejash e fitoresh. Pas përfundimit të Kongresit, luftëtarët e saj shkruan faqe heroizmi e lavdie në luftimet e Qafës së Këçikut, në Tepelenë, Kurvelesh, Vlorë, Llogara, Himarë, Therepel, Vokopolë, Rehove etj.

Njësitë e saj u takon merita e çlirimit të Sarandës, Vlorës, Sazanit, Peqinit, Rogozhinës, Kavajës, Durrësit e Shijakut.

Brigada e 12-të Sulmuese la në altarin lirisë 105 dëshmorë, të cilët i kujtojmë sot me respekt e nderim të thellë. Trimëria legjendare e djemve dhe vajzave të Brigadës së 12 nuk përfundoi më 29 nëntor 1944. Veter-



Përmet - homazhe për dëshmorët e atdheut

Permeti, ditën e dëshmorëve të atdheut e ktheu në një ditë feste. Më parë u vendos dekori tek “Përmendorja e Partizanit”, ura mbi lumi vjosë, lapidari i Br. 6 Sulmuese “Heroinë e Popullit” dhe në ambientet e varrezave të dëshmorëve. Trendafla shumëgjyrësh kudo dhe në hyrje të varezave; kurora me lule për përfaqësuesit e pushtetit vendor, shoqatën e dëshmorëve e të veteranëve, partive politike dhe institucioneve kryesore të rethit, përgatitur me shumë kulturë nga specialisti i luleve Arqile Telo. Nxënës të shkollës 9 – vjeçare “Nonda Bulka” mbanin në duar tufa me lule.

Në abientet e brëndëshme të varezave prane çdo të rëni kishin çelur zambaket. Punonjësit e Qendrës kulturore kishin vendosur këngë dhe marshe partizane. Në bulevardin kryesor u rivendos pllaka përkujtimore e dëshmorëve të qytetit.

Herët në mengjes të afërmit dhe pjestarë e familjeve të dëshmorëve kishin vendosur tufa me lule, si: familja e Kadri Seranit, Jani Dhame, Hasan Qamo, Refat Halili, Familja e Stavri Qilla, Jani Vito, Mbarea Vila, Mitat Murati, Sokol Frasheri, Kudret Dalipaj, Nesti Zhaka, familja e Myfit Tapanit, Argjir Koto e Tomor Kotori.

Morën pjesë mjaft qytetarë, pasardhës të familjeve të dëshmorëve dhe veteranëve e nxënës të shkollës.

Nën tingujt e marsheve partizane u vendosën kurora me lule në emër të bashkisë nga kryetari Niko Shupuli e Denisa Mamillo, në emër të prefektit të Qarkut Edvin Tuçi e Fadil Guci, Këshillit Bashkiak, Miranda Habili e Roland Dama, komisarit të policisë. kryekomisar Petrit Gjokaza e N/komisar Bekim Lika, familjeve të dëshmoreve Flora Hoxha e Argjir Koto, komitetit të veteranëve Ahmet Mane e Xhevair Tabaku, partitë politike, insti-



tucionet dhe shoqatat Atdhetare - Kulturore.

Mbas ekzekutimit të himnit kombëtar u mbajt një minutë heshtje para Obeliskut “Shokt”, në shënjë respekti për të rënë.

Të pranishmëve në dhomën muzeale u foli për dëshmorët e rrethit historiani Kastriot Bezati, i cili u ndal te 13 dëshmorët e pavarisës, “Heronjtë e Popullit” Musa Fratari, Skender Çaçi e Meleq Gosnishti dhe portretizoi aktin heroik të dëshmoreve Fanjo Çiçako dhe Zyrihana Xhako. U benë homazhe dhe u vendosën tufa me lule pranë varreve të të rënëve

Në emër të familjeve të dëshmoreve përshëndeti Znj. Flora Hoxha.

Muharem KAMANI

• *Brigada e 12 ka një bilanc të pasur betejash e fitoresh. Pas përfundimit të Kongresit të Përmetit, luftëtarët e saj shkruan faqe heroizmi e lavdie në luftimet e Qafës së Këçikut, në Tepelenë, Kurvelesh, Vlorë, Llogara, Himarë, Therepel, Vokopolë, Rehove etj*

anët e saj, pasardhësit dhe familjet e dëshmorëve të lirisë kanë mbajtur e mbajnë gjallë frymën antifashiste, patriotike, progresiste dhe europiane të luftëtarëve të saj.

Antifashizmi, atdhetarizmi, përkushtimi e sakrifica për liri e progres nuk vjetrohen kurrë.

Këto vlera qëndrojnë në themel të Europës dhe qytetërimit të sotëm perëndimor.

20 maji 1944 i Brigadës së 12 është vetëm 1 vit e 11 ditë larg nga 9 maji i vitit 1945, ditës së fitores së madhe të përbotshme mbi fashizmin.

Është 6 vjet dhe 11 ditë larg nga 9 maji i vitit 1950, Ditës së Europës, e cila shënoi themelimin e familjes europiane.

Prandaj vlerat antifashiste qëndrojnë në themel të qytetërimit të sotëm europian dhe perëndimor dhe ato e shtynë botën drejt të ardhmes, sigurisë, paqes dhe zhvillimit.

Prandaj kolaboracionizmi, duke i kundërqëndruar antifashizmit, e tërheq botën drejt të shkuarës, pasigurisë, errësirës dhe regresit.

IN MEMORIAM

Shtëpia e Gabajve ka 75 vite që 4 fotografi qëndrojnë pranë njëra-tjetrës

Familja Gabaj i dha Atdheut katër dëshmorë

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

FAMILJA GABAJ NË RAMICË

Në Ramicë të Smokthinës Familja Gabaj u aktivizua e gjitha në Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare. Kjo familje u përfshi si një e tërë në luftë, e cila sakrifiko deri edhe jetën e gjyshes dhe të nipëve të saj. Shtëpia e Gabajve ka 75 vite që 4 fotografi qëndrojnë pranë njëra-tjetrës. Këtë familje patriotike dhe atdhetare lufta i mori gjyshen dhe tre nipat e saj të ranë për lirinë e Atdheut. Për Smokthinë e veçantë është trimëria, atdhedashuria, burrëria dhe kënga. Kënga e smokthinjotëve është një variant i këngës polifonike labe. Këngët e trimërisë shpeshëtojnë përmes gjurmëve të 80 djemëve dhe vajzave të Smokthinës të rënë në luftë. Në veçanti për tre djemtë e familjes Gabaj dhe gjyshen e tyre.

Në këtë 75 vjetor të çlirimit të Atdheut rishfaqën ditët e luftës, vargëzimet e lartësive të fshatit Ramicë, përballë lumit Shushicë. Tek ky vargëzimi i kodrave, kudo kanë lënë gjurmë të pashlyeshme heroizimi luftëtarët e Br. V S. Në këto kodra dhe në breg të lumit të Shushicës, janë bërë luftime nga brigada. Ishin vite me luftime të ashpra. Shtëpitë e smokthinjotëve i vinte në shenjë topi i gjermanit, ndaj këndojnë për ngjarje: Në Ramicë u zu tapeja,/ Plot me gjak u mbush xhadeja. Ishin të rralla ditët pa krisma mitralozësh e pa buçima topash. Operacionet e armikut në Luginën e Mesaplikut ndiqnin njeri-tjetrin. Armiku kërkonte t'i gjunjëzonte smokthinjotët që ishin balli i qëndresës. Dërgonin nazistët gjermanë njësi special me emra të ndryshëm drejt Luginës së Mesaplikut. Secili batalion dhe regjiment ishte i egër dhe i papërmbajtur. Por edhe smokthinjotët ishin të patundur dhe nuk u tërhoqën nga pozicionet. Në një radhë me 80 djemtë e vajzat partizane të rënë dëshmorë ishte dhe gjyshja Sartë Gabaj. Ajo përcolli nipat e mbesat e saj në çetat e brigadat partizane, ndërsa vet edhe pse e moshuar e ndjente veten pjesëtare të luftës.

GJYSHE SARTA

Sarta Murat Gabaj lindi në Ramicë në vitin 1865. Tërë jetën e saj ajo u muarr me punët e shtëpisë dhe me rritjen e edukimin e fëmijëve. Për dëshmorët e familjes Gabaj në Ramicë të Smokthinës flitet dhe për gruan qëndrestare, gjyshen e palodhur dhe të përkushtuar ndaj nipëve e mbesave, për të cilët gjyshe Sarta e kishte zemrën flori dhe fjalën mjaltë. Gjyshe Sarta priti dhe përcolli në vatër kryengritës dhe e trima të hershëm të familjes Gabaj, mjetat luftëtarë. Ajo i nisi bijtë e saj në luftën e vitit 1913-1914, për mbrojtjen e Janinës dhe për luftën me andratët grekë duke ju uruar "diell tu bëhet rruga dhe shtatë drita ju lëshoftë syri!". Përsëri i dërgoi djemtë, tashmë dhe nipat në Luftën e Vlorës në vitin 1920. Ajo ishte dhe vetë një luftëtare e palodhur. Bashkë me



SARTË GABAJ



SHAMET GABAJ



GANI GABAJ



LELO GABAJ

FAMILJA GABAJ I DHA ATDHEUT KATËR DËSHMORË

gra të tjera përcillnin në vijat e luftës bukë e fishekë dhe tërhiqnin nga vijat e luftës luftëtarët e plagosurit dhe të rënë.

Në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare gjyshe Sarta ishte e moshuar, por e papërkulur. Në zemrën e gjyshe Sartës kishte bërë me kohë fole dashuria e zjarrit për luftëtarët e lirisë dhe urrejtja për pushtuesit. Në ditët e Operacionit të Dimrit, më 5 janar 1944, në shtëpinë e saj, hynë me rrëmbim disa ushtarë nazistë të shoqëruar nga ballistë. Gjyshe Sarta këmbëu fjalë të sarta me ballistët. Ushtarit nazist, kur i shpjeguan fjalët që ju tha gjyshe Sarta i zbrazti asaj në gjoks automatikun. Gjyshe Sarta u bë kësh-tu dëshmorja e parë e familjes. Për të u thur kënga: Nënë Sartën e munduan,/ Trupin me gozhdë ia shpuan,/ Vdiq me plumb në kraharruar,/ Nënë Sartën e vranë,/ Se kish djemtë partizanë,/ Sarta e Gabe, grua plakë,/ Vaditi tokën me gjak. Është shpallur dëshmor i atdheut me vendim nr. 93, datë 22.09.1972, të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

MË I RIU PARTIZAN ISHTE SHAMETI

Shamet Llano Gabaj lindi në Ramicë në vitin 1926. Pasi kreu pak arsim, filloi punë në një shoqëri italiane në Vlorë punëtor krah. Porargohet nga puna e rëndë dhe shkon në fshat duke u marrë me punët e bujqësisë dhe të blegtorisë. U përfshi në LANÇ në 1942 me organizatën e rinisë antifashiste dhe doli partizan kur ishte 17 vjeç dhe u rreshtua partizan në Br. V S më 20 janar 1944. Shameti ishte më i riu në

moshë nga djemtë e Gabe, që doli në mal partizan.

Dimri i vitit 1944 kaloi me luftime të ashpra në luginën e Mesaplikut dhe në mallet përreth saj. Në fillim të pranverës luftime zbritën në luginat e në kodrat në afërsi të Vlorës. Ditët e fundit të marsit, në ballë të luftimeve, bien në fushëm e nderit partizanët Meno Qerimi, Malo Elmazi dhe Merjeme Gjomemaj, në Peshkëpi të Vlorës. Këtu u dëgjua për herë të fundit dhe zëri i djaloshit Shamet të thërras: "Para partizanë!" Po zërin ia preu në mes plumbi... Ai ra më 31 mars 1944. Luftëtarët e lirisë floën për bëmat, guxim, trimërinë dhe i kënduan: Shamet Gaba vetëtimë,/ Vuri në kapele yll,/ I dha dyfekut fishekun,/ U hodh e doli te bregu,/ U godit me plumb në sisë,/ Ra, si bie një lis. Është shpallur dëshmor i atdheut me vendim nr. 97, datë 22.09.1972, të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

RA NË LAGJEN QOBRAT TË GJAKOVËS

Gani Bajram Gabaj lindi në Ramicë në vitin 1921. Kreu arsimin fillor në fshat dhe u muar me punët e bujqësisë dhe blegtorisë. Pushtimin fashist e priti me rrevoltë. Nuk pranoi të kryente shërbimin ushtarak dhe dezertoi nga ushtria në gusht të vitit 1942. Bëhet anëtar i çetës partizane "Plakë" në dhjetor 1942 dhe mori pjesë në të gjitha luftime që kreu kreu kjo çetë, si në Luftën e Gjormit, të Selenicës, të Drashovicës të vitit 1943. Më tej u rreshtua në formacionet luftarake të Br. V S që më 28 nëntor 1943, në Gumenicë të Vlorës. Mori pjesë në të gjitha luftime e brigadës në Shqipëri dhe deri në to-

kat e Kosovës. Më 4 tetor 1944, pranë Gjakovës në përleshje me pushtuesin ra në krye të detyrës.

Resul Bedo vite më vonë do të shkruante. Ishin një grup luftëtarësh që luftuan në Gjakovë në tetor të vitit 1944. Mes tyre ishte dhe Myslim Selimi, komisar batalioni në Br. V S. Në listën e dëshmorëve që ju kërkonin eshtrat gjendej dhe emri i Gani Gabaj. Disa ditë kërkuan në lartësitë mbi qytet, te Ura e Erenikut dhe në lagjet e qyteti. Kur u ngjitëm te kodra, mbi lagjen Qobrat të Gjakovës, Myslim Selimi tha, këtu u vra Ganiu. Në lartësinë Qobrat u muarr kënga: Gani Gabaj në Gjakovë,/ U hodh përmbi mitralozë,/ U hodh në tym e në flakë,/ Doli në Lagjen Qobrat. Është shpallur dëshmor i atdheut me vendim nr. 97, datë 22.09.1972, të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

RA NË LUFTË ME BANDAT E DIVERSANTËVE

Lelo Jazo Gabaj lindi në Ramicë në kohën e zhvillimit të Luftës së Vlorës, 1920. Punoi për bukën e gojës si çoban në Himarë, në Ujë të Ftohtë në një shoqëri italiane e më tej në minerën e Selenicës. U përfshi në LANÇ-in gjatë vitit 1943, ku ishte luftëtar i batalionit vullnetar territorial të Shullërit. Mori pjesë në luftime e zhvilluara në Gjorm, në Selenicë, në Kaninë e në Drashovicë. U rreshtua në formacionet e para partizane që u bënë repartet e Br. V S që në nëntor të vitit 1943. Në luftime e bërë nga Br. V S, në Kropisht, Peshkëpi, më 31 mars 1944 Lelua e varrosi me duart e tij vëlla Shametin dhe u betua se "do t'ia marr hakun". Luftoi në Vlorë, në Gjirokastrë, në Përmet, në Tomoricë, në Mat e në Dibër deri në tokat e Jugosllavisë.

Pas çlirimit të Atdhut, u gradua oficer dhe kreu detyrën e komandant të kompanisë. Ishte pjesëtar i Divizionit të Popullit dhe në përpjekje me bandat e diversantët, më 24 korrik 1950 dha jetën në Muhur të Peshkopisë. Dhe prapë këngë: Njëzetekatër korriku,/ Vjen në Ramicë lajm i zi,/ U vra Lelo trimi, djaloshi i ri,/ Në Dibër në Peshkopi,/ U godit në befasi. Është shpallur dëshmor i atdheut me Nr. vendimi 97, datë 22.09.1972, të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

PËRJETËSUAR NË KËNGË

Populli i ka ngritur shumë këngë kësaj familje dhe luftëtarëve të saj. Kënga më e bukur është vetë historia e saj. Familja Gabaj me tre djem që nga Ramica në Gjakovë, i lau rrugën e lirisë me gjak... Emrin e Familjes Gabaj dhe të bijve të saj janë përjetësuar në këngët e popullit. Për dëshmorët e Familjes Gabaj është shkruar vazhdimisht në shtypin e kohës, pasi ata ranë për lirinë e atdheut dhe mbeten gjithnjë yje që ndriçojnë. Këtë shkrim për dëshmorët e Familjes Gabaj të Ramicës po e mbyll me një varg kënge: Djemt e Gabajve asllanë,/ Ngulur shkëmb në istikamë,/ Aty ku luftuan ranë.

PROFIL

Në përvjetorin e partizanit të Selbës, dëshmorit të atdheut Musa Rexhep Hida (1947-2019)

MUSA REXHEP HIDA - DËSHMOR I ATDHEUT I BATALIONIT TË TRETË TË Brigadës së III-të S

Rrahman Parllaku, Hero i Popullit, për merita në LANÇ, Nderi i Kombit, i dekoruar nga Presidenti Bujar Nishani, ish-drejtues kryesor në Br.III-të S, ish-komandant i Divizionit të V-të gjatë LANÇ, Gjeneral Lejtënant dhe Zv/ministër i Mbrojtjes, Zv/Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, i burgosur politik 25 vjet, sot Kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, në deklaratën e tij të datës 11.05.2011 dëshmon edhe për pjesëmarrjen në 700 ditë luftë të ish-partizanit të Brigadës së III-të S Musa Rexhep Hida. Gjeneral Parllaku ndër të tjerat thotë se:

*“...LANÇ ishte një luftë e lavdishme që e rreshtoi popullin shqiptar përkrah fitimtarëve, përkrah aleancës antifashiste të Luftës së II Botërore dhe se kombet i mbajnë në këmbë popujt e heronjtë të LANÇ-it, partizanët heronj, që nuk mposhten, nuk vdesin dhe nuk shuhen kur-
rë. Musa Rexhep Hida ka qenë partizan i Br.IIIS, që kaloi me luftime në ndihmë të vëllezërve të tyre në Kosovë e deri në malet e Sanxhakut, mori dhe sëmundje dhe gjatë kthimit në atdhe është fakt se një pjesë e partizanëve ndërruan jetë jashtë atdheut si dhe një pjesë e partizanëve dhe bashkë me ta edhe Musa Rexhep Hida që ndërroi jetë në spitalin e Korçës, si rezultat i sëmundjeve të marra gjatë luftës....”*



Nga:

Kolonel Prof. Asoc. Dr. Agim Qamil SULA
Nënkolonel MSC Bedri Beqir MEÇULI
Nënkolonel MSC Musa Qazim HIDA
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

Selba i përket lokalitetit të Shëngjergjit. Është fshat që është shquar për urtësi e maturi, për njerëz të mirë e të dashur, që kanë mbështetur gjithmonë progresin shoqëror. Dashurinë për atdheun, për truallin arbëror e kanë pasur pa kushte. Fshati Selbë ka 120 shtëpi, por që kishte gjatë luftës 30 partizanë. Përgjatë LANÇ-it, ishte dhe mbeti çerdhe e lirisë dhe mbështetëse e fuqishme luftës Nacionalçlirimtare për ushqime e veshmbathje. Me traditat patriotike e luftarake dhe mikpritjen e rrallë u rritën djemtë e vajzat e fshatit që lindi, rriti dhe mëkoi luftëtarë atdhetar dhe antifashist. Musa Rexhep Hida ishte lindur më 7 korrik 1922, në fshatin Selbë të Tiranës. Rridhte nga një familje e shquar patriotike e atdhetare. Musai mori këtë emër për nder të luftëtarit me armë në dorë gjyshit të tij Musa Ali Hidës, i cili kishte qenë pjesë e formacioneve luftarake Austro-hungareze më 1915-1918 të Luftës së Parë Botërore, në zonën përreth Tiranës. Musai i parë pas LIB fitoi popullaritet të madh, ishte njeri shumë i besuar i zonës dhe kryeplak i fshatit. Në vitet e rënda të pushtimit fashist në Selbë jetonte Rexhep Hida me familjen e tij, i cili punonte e jetonte me punë bujqësore e blegtorale. Rexhepi dhe bashkëshortja Hanke gëzonin respektin e gjithë njerëzve në fshat e krahinë. Rexhepi dhe Hankja kishin shtatë fëmijë, pesë djem: Qazimi, Mexhiti, Ramazani, Musai, Aliu dhe dy vajza: Hamide dhe Selime. Familja e tij ishte e njohur dhe e respektuar në Selbë dhe në krahinë. Djali i katërt i Rexhepit, Musai sikurse edhe bashkëmoshatarët ndoqi disa klasë të fillores në vendlindje në Selbë, shkollë e cila ishte hapur rreth vitit 1915 dhe për arsye financiare shkolla u mbyll. Fëmijët e asaj kohe ju kthyen punëve të shtëpisë në fshat e në mal për të lehtësuar fukarallëkun e kohës. Vitet kaluan dhe Musai u rrit e burrërua, hodhi shtat dhe u bë djalosh i fuqishëm shpatullgjërë dhe muskuloz. Simpatizonte veprimtarë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Të rinj e të reja që shpërndanin trakte nëpër katunde për të sqaruar pop-

ullin për fashizmi dhe pse duhej luftuar. Kishte ardhur ora për çlirim e liri kombëtare. Në emër të atdhetarizmit duke pasur urrejtje për fashizmit, në vazhdim edhe të traditës, kur partizanët erdhën tek stani i tij në Malin e Kurorës pranë Selbës, Musai la kërrabën në kasolle dhe u bashkua me partizanët. Misioni për lirinë e atdheut ishte mbi gjithçka. Partizanët e pajisën që në ditën e parë me pushkë e me pistoletë, duke i plotësuar ëndërrën e fëmijërisë, për të luftuar armikun. Vëllezërit dhe motrat e mbështetën fuqishëm. Ndihmonin partizanët me veshmbathje e ushqime. Tradita luftarake e familjes e shoqëroi në të gjithë luftimet. Ai u rrit, u burrërua më tej si dhe u shqua në luftimet e ashpra partizane. Në jetën e malit perfeksionoi edhe dijet e marra në shkollë. Ai luftoi në batalionin e tretë të Br.IIIS, në Rrethinat e Tiranës, në Elbasan, në Korçë Përmet e Gjirokastrë deri në Fushëbardhë. Njohu komandantë e komisar, bashkëluftëtarë nga e gjithë Shqipëria e Kosova. Luftoi edhe në Veri, në Dibër e Kokës e në të gjithë Kosovën deri në Mitrovicë e më tej. Musai 21 vjeçar në radhët partizane ishte qitës i i shkëlqyer dhe i apasionuar. Me formacionin e batalionit të tretë në Br.IIIS partizane, shkroi histori suksesi dhe lavdi në luftimet brenda e jashtë vendit bashkë me shumë shokë partizanë si: Mexhit Doka, Myzafer Spaho, Selman Doka, Musa Tafani, Ramazan Beqiri, Musa Joca, Nexhip Selimi, Qamil Ceka, Mexhit Rrahmani, etj. Nuk u tërhoq dhe pezmatua edhe kur ngeli eibllokuar në dëborë në rajonin e Tropojës, për nëntë ditë rresht skuadra partizane ku bënte pjesë edhe Musa Hida në kushtet e një dëbore të madhe u gjendën nga shokët e tyre të batalionit dhe u rehabilituan shpejt, duke ju rikthyer luftimit në luftimet çlirimtare. Ata e ndoqën armikun këmba-këmbës dhe djali i Selbës ngeli në panteonin e lirisë bashkë me dëshmorët e tjerë të fshatit Selbë në rrethinat e Kryeqytetit. Kalimi “zyrtar” i kufirit nisi me një batalion më 19.10.1944 në Qafë Morinë, kur brigada kishte 1000 partizanë tashmë me eksperiencë në luftime. Për batalionet e Br.IIIS, hapej një fletë e re, sidomos për fatin e vëllezërve tanë kosovarë përtej kufirit shtetëror. Mjedisi i ri dhe situatat luftarake në ndjekje të armikut gjatë tërheqjes së tij strategjike ishte prioritet i Brigadës, batalioneve e deri tek partizani më i fundit. Lufta e partizanëve shqiptarë jashtë kufirit ishte më shumë se luftë ideali, prandaj dhe veprimtaria

e partizanëve jashtë kufirit shtetëror u mbuluan me lavdi. Musa Rexhep Hida ka ndërruar jetë më 29.1.1947, në spitalin e Korçës, ku djaloshin partizan që nuk e mundën sfidat e rreth dy viteve luftë e sakrifica, e shoi në pak kohë sëmundja, që kishte prekur dhe partizanë të tjerë që kishin luftuar jashtë kufirit shqiptar. Musa Rexhep Hida jetoj pak, vetëm 25 vjet, por shkroi histori lirie dhe çlirimi. Ligji nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, në nenin 5 “Kriteret për shpalljen e statusit “Dëshmor i atdheut” pika “ë”) shprehet se Dëshmorë të Atdheut shpallen për “shtetasi shqiptarë, pjesëmarrës në formacione të rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të cilët kanë humbur jetën brenda datës 9 maj 1947 për shkak të sëmundjeve dhe plagëve të marra ose fatkeqësive të ndryshme, duke qenë në krye të detyrës luftarake”. Kjo pikë e ligjit plotëson atë boshllëk të munguar në legjislacionin e mëparshëm dhe çet hapësira ligjore, për shpalljen e Musa Rexhep Hida ish-efektiv i batalionit të tretë partizan në Br.IIIS, t’i jepet titulli i nderit: “Dëshmor i atdheut”. Brigada e III Sulmuese zhvilloi 700 ditë në luftë nga lufta e Arbanës më 9.10.1943, ditën e themelimit me 600 partizanë, ku përshkoi një rrugë luftarake të lavdisë me 3500 km, bëri 250 aksione luftarake; i dha atdheut 255 dëshmorë, përfshi dëshmorin Musa Rexhep Hida, përballoi operacionin nazist “505” në Pezë, operacioni “1828” në Çermnikë, luftuan në gjithë Shqipërinë dhe Kosovë dhe ngelën në kujtesën e kombit shqiptar për lavdinë që shkruan në altarin e lirisë. Një pjesë e partizanëve të saj të prekur nga tifua u shtrua në spital të Korçës, ku ndërroi jetë dhe partizani nga Selba Musa Rexhep Hida më 29.01.1947, por ndriçon si pishtar i përhershëm i idealeve partizane, sepse asgjë nuk është më frymëzuese sesa Lufta e madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare, që qëndron si margaritar në gjerdanin e stolive të shqiptarëve. Shqiptarët në Aleancën e Madhe Antifashiste të Popujve; çliruan Shqipërinë pa ndërhyrjen e aleatëve, dhanë kontribut të çmuar në luftë me aleatët e mëdhenj: Anglia, Rusi e SHBA, gjunjëzuan nazifashistët dhe siguruan lirinë e popujve dhe të kombeve.

FOTOREPORTAZH

Gjeneral Parllakut vazhdojnë t'i vijnë urime të përzemrta për 100 vjetorin e ditëlindjes

Ju dhatë një kontribut të çmuar për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare

Gjeneral Rrahman Parllakut
Hero i POPULLIT
President i OBVL

URIM PER 100 VJETORIN E LINDJES

I dashur Zoti Parllaku,
Presidiumi i Komitetit Këshillimor Nërkombëtar i Organizarës të Oficerëve në Rezervë ju uron 100 vjetorin e lindjes. Ju jeni njëri nga ata që luftuat nazi-fashizmin dhe mbrojtët lirinë e popujve të Europës duke i shpëtuar gjeneratat e ardhshme nga skllavëria. Ju dhatë një kontribut të çmuar për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Si Kryetar i OBVL Ju i shërbeni kauzës për forcimin e besimit dhe mirëkuptimit të ndërsjelltë mes kombeve dhe shteteve.

Urojmë shëndet e prosperitet për Ju dhe familjen Tuaj. Ju urojmë mbarësi, suksese dhe jetëgjatësi.

E kemi për nder t'Ju ftojme në Sofie, pasi Ju jeni HERO, jeni pjesëtar i Luftës Botërore dhe Misionar i Paqes.

Respekte,

Presidenti i Komitetit
Alexander Kanshin

Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit
Anatoly Kumakhov

KOMITETI KESHILLIMOR NDERKOMBETAR I ORGANIZATES TE OFICER-EVE NE REZERVE
Moskë, Rusi.

Me shumë dashuri e respekt, O gjeneral i Madh....edhe i imi!

I dashur dhe i nderuar gjeneral!

Ndjehem shumë i gëzuar që më jepet mundësia t'ju uroj 100-vjetorin e lindjes. Urimet më të përzemërta me dëshirën për një jetë të gjatë e të lumtur në Familjen tuaj të nderuar plot besim e dinjitet.

I nderuari gjeneral i vërtetë!...

Siç duket, zërendit janë marrë vesh me njëra-tjetrën të jetoni gjatë, si shprehje konkrete e një qëndrimi prej stoiku, për të dfrjetën dhe të vërtetat e Luftës, të përpjekjeve njerëzore e të jetës shqiptare.

Me shumë dashuri e respekt, O gjeneral i Madh....edhe i imi.

Përzemërsisht
Limos DIZDARI

Më pëlqen kur flisni nëpër intervista sepse jeni objektiv

Përsëndetje Z. Parllaku,

Si fillim uroj të jeni mirë ju dhe familja juaj. Ne media mora vesh që keni festuar 100 vjetorin. Ta gëzoni ditëlindjen!

Unë ju njoh vetëm nga media dhe kam një vlerësim për figurën tuaj. Ju keni qenë pjesë e rëndësishme gjatë luftës së dytë botërore dhe jeni dënuar edhe nga regjimi komunist për një kohë të gjatë. Më pëlqen kur flisni nëpër intervista sepse jeni objektiv. Vlerësoni kontributin e vërtetë të të rinjve që luftuan për të çlituar vendin tonë nga pushtuesi i huaj me shpresën që do të kishim një vend më të mirë pas çlirimit. Gjërat më vonë shkuan shumë keq për të gjithë, edhe për ju që rrezikuat jetën disa herë në luftime. Ju keni qenë pjesë e rëndësishme e luftimeve në Mal të Zi, Bosnjë dhe prandaj po ju shkruaj.

Gjyshi im SALI DODA ka qenë partizan në brigadën e 7 sulmuese në fillim dhe më pas në brigadën 22. Kishte mbaruar akademinë ushtarake në Modena dhe më pas ishte specializuar në Parma në Itali për tankist, po aty në fillim ka

qenë si partizan i thjeshtë.

Luftimet në Mal të Zi ai i kujton-te gjithmonë, sidomos luftimet në Vishegrad. Në një moment thotë

.....Përpara meje nja 15 metra larg ishte vendosur një mitraliere që kishte dykambësh inglez. Besoj se nuk i kishte mbushur 15 vjetët. Më përngjante me motrën e vogël time. Ishte guximtare e madhe...

Është e vërtetë ajo që thoni ju nëpër intervista që morën pjesë shumë të rinj djem dhe vajza të një moshe të vogël.

Në vitin 1946 u dënua si "Armik i Popullit" dhe pasi u lirua nga burgu punoi në fermë. Gjithmonë ju mohua kontributi dhe sakrifica e tij gjatë luftës.

Unë vij nga një familje ish e përndjekur politike por mendoj që kontributi i luftëtarëve të vërtetë duhet vlerësuar.

Sa herë shikoj personazhe si puna juaj më kujtohet koha kur ka luftuar gjyshi im.

Singerisht,
Ervin Doda



KËNGË PËR GJENERAL RRAHMAN PARLLAKUN (Legjenda e kombit)

Nga MUNIR DALI HOXHA

**Fushë në fushë e mal në mal
Si s'u lodhe gjeneral,
Ishe djalë e mbete djalë
Luftëtar e trim i rrallë..**

**Bir i Novosejt trim
Kur Atdheu dha kushtim;
Në dëborë e suferinë
Dole malit për lirinë...**

**Se të rriti ty kjo tokë
Si një lis me rranjë të fortë,
Si i luftës, lapidar
Je si lis njëqindvjeçar...**

**O Rrahman, Rrahman Parllaku
Dritë lirie t'u ba gjaku
Të kujton djali e plaku
Se ti je shqipe bajraku...**

**Që nga Kukësi gjer në Vlorë
Nëpër male plot me borë,
Mbetë me nagant në dorë,
Shqiptarinë vune kurorë...**



**Në çdo gur e në çdo shkamb
E ke gdhendur emrin tand,
Ç'a ke ba ti për Atdhen
Kurr Shqipnia s'ta shpërblen...**

**Në Shqipni e në Europë,
Je i vetmi fitimtar
E do mbetesh mbi këtë tokë
gjeneral mbi gjeneralë....**

**Ndoshta vitet do kalojnë,
Ndoshta koha mund të ndalë
Brezat kurrë nuk do të harrojnë
Emrin tand o gjeneral...**



KOMENT

Ekzistojnë fakte, dokumente e dëshmi të pakontestueshme se në Kosovë forcat ushtarake paramilitare dhe policore të Serbisë kanë kryer krimet më mizore

DIALOGU PRISHTINË - BEOGRAD NË RRUGË PA KRYE

Nga Bashkim Hisari

Njëzet vjet pas ndërhyrjes së NATO-së, Kosova është e pavarur por Serbia ende nuk po pranon faktin që e ka humbur atë si rezultat i krimeve të forcave të tyre ndaj njerëzve të pafajshëm në vitet 1998-1999. Përkundrazi, rilindja e vulgaritetit politik serb nuk ka fund. Në Sërbi besimi pa merita po blihet, historia po "hekuroset" duke synuar të nivelizohen partizanët dhe çetnikët, po rehabilitohen çetnikët fashist si Drazha Mihailović, Nedic dhe Ljotić, pastaj edhe të dënuarit për krime lufte dhe ata që nuk heqin dorë nga politika luftënxitëse, vrasëse, që përhapin urrejtja, injorancë, inat e ksenofobi. Të gjitha këto janë degraduese dhe frikësuese për raportet Kosovë-Serbi, të dëmshme për marrëdhënie të mira fqinjësore në rajon dhe shpiejnë arritjen e një marrëveshjeve në qore.

Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën për gjenocidin serb në Kosovë. Në institucionin më të lartë ligjdhënës të Kosovës, rezoluta u miratua me 79 vota, pa asnjë votë kundër e apstenim dhe pa pjesëmarrjen e deputetëve serb. Deputetët pretendojnë se rezoluta da të hapi rrugën e nismës për krijimin e një Tribunali që do të ndjekë dhe gjykojë krimet të kryera nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë të vitit 1998-99. Mirëpo, rezolutat nuk janë akte ligjrisht të detyrueshme, andaj ajo nuk do të ndikojë në realizimin e të drejtave të viktimave dhe familjeve të tyre në drejtësi, reparacion dhe në gjetjen e së vërtetës. Kuvendi i Kosovës bashkë me të gjitha institucionet tjera duhet të angazhohen më shumë dhe të veprojnë në mënyrë të koordinuar e më me guxim në intensifikimin e ndjekjeve penale kundër të gjithë atyre që kanë krye krime, të vërtetojnë faktet mbi krimet e luftës në Kosovë dhe të mbështesin të mbijetuarit, viktimat dhe familjet, sipas sundimit të ligjit.

Ekzistojnë fakte, dokumente, e dëshmi të pakontestueshme se në Kosovë forcat ushtarake paramilitare dhe policore të Serbisë kanë krye krime më mizore. Kanë dëbuar afro 1 milionë Kosovar. Kanë vrarë dhe masakruar më shumë se 13.500 shqiptarë të cilët nuk kanë marrë pjesë në luftime, prej tyre 1.393 fëmijë, 1.379 gra. Çështja e mbi 1.600 personave ende të pagjetur mbetet njëra ndër temat kryesore për familjarët të cilët presin ndonjë lajmë të mirë. Një plagë tjetër e luftës janë edhe rreth 20.000 gra e burra të ciët janë viktimat të dhunës seksuale. Gjatë konfliktit forcat serbe shkatërruan mbi 100 mijë objekte banimi, ndërtesa



shkollore, objekte fetare e kulturore. Dëmet materiale që Serbia i ka shkaktuar Kosovës llogariten të jenë më shumë se 15 miliardë euro. Pra, e vërteta është se populli i Kosovës jo vetëm që ishin viktimat, por mbi ta janë ushtruar aktet e gjenocidit dhe ato patjetër duhet të sanksionohen me efekte juridike.

Gjykata Ndërkombëtare Penale për krime në ish-Jugosllavinë, e njohur si Gjykata e Hagës, e ka lënë në gjysmë drejtësinë për krimet kundër njerëzimit të kryera nga shteti serb në Kosovë. Edhe pse krimet e forcave serbe janë dokumentuar dhe denoncuar kriminelët nuk janë gjykuar për aq sa është e duhur sepse edhe në disa raste të përfunduara, ka ndodhur që krerët e gjenocidit kanë marrë dënime minimale. Disa prej tyre tanimë janë liruar dhe marrin pjesë në aktivitete politike. Parada ushtarake e Serbisë që është mbajtur sivjet më 9 maj në Nish me rastin e Ditës së fitorës mbi fashizmin dhe Evropës, është udhëhequr nga gjenerali serb, Vladimir Lazarević, ish-komandant i armatës së tretë që ka vepruar gjatë kohës së ish-Jugosllavisë në Prishtinë i cili nga Tribunali i Hagës është dënuar me 14 vjet për krime kundër njerëzimit, për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe për trajtime çnjerëzore.

Në gjykimet e UNMIK-ut, EULEX-it dhe në Gjykata Kosovare janë dhënë 189 vjet burgim për shqiptarët dhe vetëm 20 vjet burgim për serbët. Të dënuar në Kosovë janë: 34 shqiptarë, 4 serbë, 1 rom. Të dënuar në Serbi: 15 serbë, 1 shqiptar dhe qindra të tjerë shqiptarë me aktakuza të

shtetit serb.

Të dënuar në Hagë: 6 serbë, 2 shqiptarë. Veç kësaj, Republika e Kosovës e ka edhe Zyrën e Prokurorisë të Specializuar që është një prokurori e ndërkombëtarizuar dhe e zhvendosur në Hagë, e krijuar për hetimin dhe, nëse është e nevojshme, për ndjekjen penale të individëve për krimet e pretenduara në raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropë.

Megjithatë në Serbi po ringjallen elementë profashistë. Serbia ende nuk ka kërkuar falje, po fsheh faktet e krimeve, po vazhdojnë me mohimin e krimeve që janë bërë dhe po përpiqet që të ndërroj të vërtetën duke u paraqitur si viktim. Me deklarata ofenduese ata po provojnë të mohojnë rreth 400 masakrat të bëra nga forcat e tyre mbi civilët e pafajshëm. Kriminelët serb të dënuar për krime të luftës, bashkë me serbët "të mëdhenjtë" nga rajoni të cilët nuk kanë pasur mundësi të dëshmojnë serbizmin e tyre gjatë viteve 90-ta, me kapacitet të plotë nën kontrollin e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiqit janë duke punuar në çështjen e Kosovës, përkatësisht për të mbrojtur serbizmin në të gjitha ish-shtetet serbe, si preferojnë të trumpetojnë dhe quajnë jo vetëm Kosovën por edhe Bosnjë-Hecegovinën e Malin e Zi. Individëve ekstrem racist e neofashist dhe monstrumet politike serb të cilët me ulërimet e tyre përhapin urrejtje dhe iden e Serbisë së madhe, janë bashkangjitur edhe luftënxitësit kleronacionalist të kishës ortodokse serbe që po përdorin parimin e rrejshim historik, mitin mbi Kosovën, shtetin mesjetar serb, kishat dhe manastiret të cilat marrin si argument kryesor për të pohuar se Kosova i takon atyre. Por, kishat dhe manastirat në Kosovë janë ndërtuar në kohën e Bizantit, nuk kanë qenë serbe as shqiptare por krishtere. Kosova kurrë nuk ka qenë pjesë e Serbisë por ka qenë pjesë e Bizantit. Në shekullin XIII pasi pushtohet Kostantinopojja dhe dobësohet Bizanti, mbretëria e vogël serbe shfrytëzon këtë situatë, pushton Kosovën dhe sundon 50 vjet. Kishat dhe manastirat krishtere gjithnjë kanë gëzuar respekt ndër shqiptarët.

Pikëpamjet e Prishtinës dhe të Beogradit lidhur me zgjidhjen e çështjes së Kosovës janë akoma diametralisht të kundërta. Derisa për Prishtinën njohja e pavarësisë së Kosovës është çështje më e rëndësishme, për Beogradin pavarësia është absolutisht e papranueshme, pavarësisht nga marrëveshja e nënshkruar në Bruksel në vitin 2013, e cila u nënshkruar nga kryeministri i atëhershëm i Serbisë Ivica Dačić

së bashku me Hashim Thaçin, përfaqësuesin e Lartë të BE-së Catherine Ashton dhe Zëvendëssekretari e Përgjithshëm të NATO-s Alexander Vershboë, me të cilin pala Serbe faktikisht pranoi pavarësinë e Kosovës dhe më 22 prill të të njëjtit vit, qeveria serbe dha pëlqimin. Mirëpo, ajo u refuzua fillimisht nga përfaqësuesit e serbëve të Kosovës dhe Kisha Ortodokse Serbe dhe pastaj përfaqësuesit e qeverisë aktuale ndryshuan mendimin dhe vazhdimisht përsërisin se Kosova është Sërbi dhe kurrë nuk do të njohin pavarësinë e Kosovës.

Këto ditë edhe një përbërje e Komisionit Evropian përfundoi mandatin. Dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit vazhdon të ngeli në një rrugë të pakryer kurse arritja e një marrëveshjeje është gjithnjë më larg. Përkundër faktit se Bashkësia ndërkombëtare konsideron se është koha për të zgjidhur problemet në Ballkanin Perëndimor ashtu siç dëshiron edhe Rusia të mos arrijë zgjidhja, dhe rajoni të jetë grope e zezë në Evropë, negociatat e deritashme me ndërmjetësimin BE nuk dhënë rezultate. Është më se e qartë se ngecja e negociatave nuk kontribuoi në arritjen e një Marrëveshjeje për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Kjo u dëshmuar edhe në samitin e Berlinit për Ballkanin Perëndimor që u mbajt nën drejtimin e kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit të Francës Emmanuel Macron ku morrën pjesë edhe udhëheqësit më të lartë të Kosovës dhe Serbisë. Edhe një here u vërtetua se për zgjidhjen e kësaj çështjeje është më e rëndësishme pajtueshmëria dhe kohezionin midis SHBA dhe BE. Derisa nuk arrihet një marrëveshje lidhur me një kornizë dhe përmbajtje ndërmjet SHBA dhe BE për negociatat për Kosovën nuk do të ketë përparim në dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Problemi qëndron në BE e cila ka pengesa për të intensifikuar dialogun. Nga ana tjetër, palët në negociatë nuk ofrojnë ndonjë solucion për zgjidhje konkrete, Mungesa e unitetit të partive politike shqiptare të cilët kryesisht prioritet kanë interesat e tyre politike, pastaj edhe skandale të shumta në shërbimin e jashtëm të Kosovës ku pa kriteret e mirëfillta akomodohen kuadrot partiake dhe familjarët e politikanëve që nuk arrijnë të sigurojnë njohje të reja e as antarsimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, edhe më shumë komplikojnë situatën. Andaj, pa përfshirjen e SHBA është vështirë të gjendet një zgjidhje për një problem evropian, atë mes Kosovës dhe Serbisë.

HISTORIA

77 VJET MË PARË

Çeta Partizane e Dibrës dhe aksionet e saj luftarake

Nga Sakip Cami

U formua në Zogje në shtëpinë e Haxhi Lleshit. Në çetë u rreshtuan 20 partizanë. Përveç anëtarëve të celulës, të pranishëm ishin Demir Gashi, Xhavit Hatipi, Beshir Laçi, Ilmi Çaushtolli, Musa Lala, Ali Pepa, Sulë Muça, Rrahman Dervishi, Bajram Buci, Nuz Majtara, Shefki Riza Lleshi, Ymer Lleshi, Hamdi Lleshi, Bajram Nezirri, Sulë Lleshi, etj. Komisar u caktua Qazim Prishtina, ndërsa komandant Haxhi Lleshi.

Çeta u krijua në Kodrën e Limume, përballë "Vishkullit", një pemë shekullore dëshmitare e shumë ngjarjeve të mëdha historike të fshatit Zogje (sot monument natyre). Pesë partizanë kanë qenë baza e kësaj çete, shtylla vertebrale e saj, shoqëruesit më besnikë të Haxhi Lleshit në Dibër dhe jashtë Dibrës deri në Përmet. Ata kanë qenë Musa Lala nga Strikçani, Sulë Muça nga Selishta, Ali Pepa, Rrahman Dervishi dhe Bajram Buci nga Lukani i Katër Grykëve.

Pas kalimit të Haxhi Lleshit në detyrën e komandantit të batalionit të Dibrës më 26 korrik 1943 drejtimin e kësaj çete e mori Ymer Lleshi.

AKSIONI I PARË I ÇETËS, GODITJA E POSTËS USHTARAKE ITALIANE, TEK "GURËT E SKËNDERBEUT", 27 QERSHOR 1942

Natën e formimit të Çetës u vendos të organizohej aksioni i parë tek Gurët e Skënderbeut afër Bulqizës. Partizanët dhe vullnetarët ishin të armatosur me pushkë të ndryshme, italiane, serbe, austriake, greke etj. Kishim edhe një mitroloz të lehtë të markes çeke "Bërno", të cilin e mbante Haxhi Lleshi.

Pa gdhirë data e 27 qershorit njësi-ti i ndarë në grupe u nis nga shtëpia e Mustafa Çakallit e Dullë Gjinit dhe zunë pritë tek Gurët e Skënderbeut. Sapo u shfaq kamjoni i Postës ushtarake u dha sinjali dhe plasi pushka. Partizanët kishin bërë edhe një bllokim rruge me gurë, që të mos kishte mundësi shoferi që të manovronte me shpejtësi.

Në këtë aksion luftarak u vranë 3 italianë e disa të tjerë u plagosën. Gazeta "Tomorri" që transpotonte posta, u bë shoshë nga plumbat dhe kësh-tu u shpërnda në Dibër të Madhe, gjë



që bëri jehonë të madhe dhe tronditi mjaft autoritetet italiane. (H.Lleshi, kujtime, faqe94)

AKSIONI TJETËR I ÇETËS, PRE-RJA E TELAVE TELEFONIKË, 24 KORRIK 1942

Më 24 korrik u bë prerja e linjave telefonike që njihet si aksion kom-bëtar në shkallë vendi. Çeta e Dibrës së bashku me fshatarë vendas preu 10 shtylla të linjës telefonike Maqellarë-Peshkopi-Slllovë e Dibër e Madhe-Zerqan-Bulqizë. Mungesa e lidhjeve telefonike vuri në alarm të madh garnizonet ushtarake dhe adminis-tratën e forcave pushtuese.

PËRPPJEKJA TEK URA E TOPOJANIT, 24 GUSHT 1942, PLAGOSJA E HAXHI LLESHIT

Përppjekja me italianët tek Ura e Topojanit ku u plagos komandanti i Çetës Haxhi Lleshi u bë duke u gdhirë më 24 gusht 1942. Partizanët e Çetës së Dibrës të drejtuar nga Haxhi Lleshi zbresin nga Luznia për tek Ura e Topojanit për të shkuar në Dibër të Madhe. Lumi i Drinit të Zi ishte plot e përplot nga shirat e shumtë që kishin rënë. Kalimi në va' ishte i pamundur Di-hej që ura ruhej nga italianët, të cilët kishin ngritur edhe një vëndroje të fortifikuar. Ishte natë, por hënë ndriçon-te mirë. I pari ishte Haxhi Lleshi me

mitroloz në dorë. Musa Lala i doli përpara. Qëndro pas meje, o Haxhi, se ti duhesh ma shumë se unë për luftën. Në krah i dolën edhe Rrahman Dervishi dhe Qazim Prishtina, komisari i çetës. Kur arritën në mesin e urës, partizanët diktohen dhe qëllohen nga rojet italiane. Haxhiu plagoset në këmbë, por vazhdoi të qëllojë me mitrolozin e lehtë që kish me vehte, duke i vendosur edhe karikatorin e ri. Rrahman Dervishi dhe Musa Lala godasin fort me granata dore në drejtim të italianëve dhe të pozicionit të tyre të fortifikuar. Vendi u bë tym e flakë. Haxhiu, Rrahmani dhe Musai arrijnë të kalojnë urën dhe të shkojnë tek Kadri Demiri në Allajbegi. Nëna e Kadriut ishte halla e Haxhiut, e cila i mjekoi me shpejtësi plagën, Haxhiut. Pjesa tjetër e Çetës tërhiqet në Shpukth ku vendoset tek Mersin Skarra e Mersin Biçi. Mersini ishte mjek popullor dhe ja mjekoi plagën Haxhiut. Kuestura e Dibrës më 24.08.1942 i raporton Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë: "Në orën 01 45 të natës një grup banditësh tentuan të kalonin Urën e Topojanit mbi lumin Drin... Nga intensiteti i zjarrit mendohet që banditët të kene qenë në numër të konsiderueshëm dhe me sa duket kishin edhe armë automatike.

AKSIONI PËR DËBIMIN E ITALIANËVE NGA MINIERA E BULQIZËS, 16 - 17 SHTATOR 1942

Më 16-17 shtator u organizua aksioni në Minjerën e Bulqizës, ku u dëbuan punëtorët italianë të firmës italiane "AMMI" dhe u ndërpre prodhimi. Udhëheqës i aksionit ishte Nazmi Rushiti i cili bashkë me Demir Gashin u kthye në Zerqan, ndërsa një pjesë e grupit shkoi në Martanesh në pritje të shokëve që ktheheshin nga Konferenca e Pezës.

LUFTA E MAQELLARËS (14 GUSHT 1943)

Në mëngjesin e datës 14 gusht 1943, nga qyteti i Dibrës së Madhe doli një autokolonë e madhe ushtarake e shoqëruar para dhe pas nga autoblin-da. Pasi kaloi Bllatën, autokolona po

i afrohej Maqellarës. Çeta e grykës së Vogël ishte në Gjoricë, Çeta e Grykës së Madhe në Homesh dhe Çeta e Slllovës në Reshan. Me të parë këtë autokolonë forcat e dy çetave partizane të Grykës së Vogël dhe të Grykës së Madhe me shpejtësinë më të madhe, megjithëse terreni ishte fushor dhe i ekspozuar, kaluan Drinin e Zi dhe rrugën automobilistike dhe nga Kërçishti dhe Pocesti arritën në kodrat e Pesjakës dhe në Obok.

Zunë pozicione të forta mbi kodrat e Pesjakës dhe pritën autokolonën. Pasi u lanë që të kalojnë autoblin-dat, kur makinat me ushtarë hynë në rrezen e veprimit të armëve partizane, filloi një zjarr i fuqishëm që tronditi armikun. Autokolona e armikut ndaloi dhe filloi lufta tokësore midis partizanëve dhe fashistëve italianë. Lufta filloi në orën 09.00 të mëngjezit dhe vazhdoi deri në mbrëmje. Italianët arritën të organizohen, të zënë pozicione dhe me ndihmën e autobлиндave të kundërsulmojnë në drejtim të pozicioneve të Çetës së Grykës së Vogël.

Me gjithë zjarrin e autobлиндave dhe të mitrolozave të armikut, sulmet e italianëve u thyen dhe komanda italiane kërkoi ndihmë nga Dibra e Madhe dhe nga Peshkopia. Nga Dibra e madhe erdhën edhe tre autoblin-da, të cilat morën pjesë në luftime, por pa dobi për armikun. Çeta e Slllovës ndodhej në Reshan dhe prej andaj kaloi nëpër Allajbegi për t'u ardhur në ndihmë forcave partizane që luftonin në Maqellarë. Italianët duke parë se nuk po përparonin dot megjithë epërsinë në forca dhe mjete, vendosi të kthehej mbrapsht nga kishte ardhur, nga Dibra e Madhe. Në këtë betejë armiku la 100 të vrarë, shumë të plagosur, dy automjete të djegura dhe disa të dëmtuara. Forcat partizane nuk patën humbje. (Ushtima e maleve, datë 26 korrik 1969)

U dogj Posta e xhandarmërisë në Maqellarë. Në kthim për në Dibër të Madhe dogji disa shtëpi në Maqellarë, ndër to edhe shtëpinë e Fiqiri Dines, për të cilën italianët kërkuan ndjesë se nuk e dinin se ishte shtëpia e tij dhe e zhdëmtuan Fiqiri Dinen për dëmin e shkaktuar, një kamion me ushqime dhe para. Fiqiri Dineja po kthehej nga Dibra e Madhe ku kishte qenë në takim me krerët e Ballit Kombëtar dhe nuk u fut në luftë me italianët, megjithëse i dogjën edhe shtëpinë e tij. (Sipas librit „Lufta antifashiste e popullit dibran, faqe 101 – 104“) Burime të tjera thonë se Fiqiri Dine ka luftuar kundër italianëve, por taktika dhe strategjia e tij ka qenë që luftimet të bëhen jashtë qendrave të banuara, që të mos vritet popullsia civile (S.C., shënimi im)

BATALIONI PARTIZAN I DIBRËS U FORMUA ME 26 KORRIK 1943

Më 18 gusht 1944 Batalioni Partizan i Dibrës u rreshtua në Br.XVII S.

Komanda e Batalionit Partizan të Dibrës: Haxhi Lleshi (komandant), Esat Ndreu zv.komandant, Njazi Islami komisar, Sotir Vullkani zv.komisar, (Prokop Murra).



REPORTAZH

Valët e lirisë që nuk u shuan kurrë në Kosovë, në vitin 1999 sollën përmbushjen e ëndrrës shekullore kombëtare të lirisë së Kosovës

VULLKANI I LIRISË

Ing. Kol Dedaj

Valët e vullkanit të lirisë Kombëtare në trojet ilire qëndruan të ndezur ndër shekuj e mijëvjeçar, ato u bënë aktive sa herë kombi kishte nevojë. Një komb i lashtë sa vetë lashtësia, ku fiset ilire shpërndanë qytetim ndër popujt e tjerë. Fisi ilir i Pirusve ishte i shquar në punimin e metaleve (arit, argjendit, etj.), një veçanti e fisit Dalmat ishte veshja e tyre Kombëtare e quajtur "Dalmacia", e cila u përhap edhe në Romë ndër qarqet më të larta të atij qytetrimi, kjo veshje me kalimin e kohës u ndryshua dhe mbeti si veshje liturgjike e kishës katolike deri në ditët e sotme (Prof. Dr. Karl Patsch, Gjendja ekonomike dhe kulturore e Shqipërisë në kohën e kalueme, Tiranë 1923, f22). Gjithashtu deri në ditët tona erdhën edhe toponimet dhe mbartësit e tyre siç është rasti i emrit Berishë-Bertiscus, emër i mocëm me të cilin quheshin Alpet e Shqipërisë së verit (Prof. Dr. Karl Patsch, ilirët, Tiranë 1923, f.6)

Për shehku me rradhë të mbështetur



në qëndresën e tij shqiptari ruajti kombësinë, gjuhën, zakonet, traditat dhe kulturën e vet në luftë të vazhdueshme me armiqtë e panumërt, ruajti atë tokë të kreshpëruar, brinjëdalë, nga rrebeshtet e historisë, ato fusha si kurorë që gjelbëron në shtatin e tij, ruajti e derdhi gjak për këtë truall të lashtë, të vyer e të shtrejtë, ruajti Shqipërinë tonë të dashur. Shfletojmë albumin e madh të historisë sonë në murgëtitirën e mjergulluar të shekujve, nën vërgëllimat e shpatave dhe buqitjete të topave, "Nënë Shqipëria", bashkë me bijtë e saj po lindte dhe trimërinë armën më të fuqishme me të cilën shqiptarët do të çanin gjithmonë përpara që në kohërat iliro-arbënore, duke spikatur me madhështinë e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, ku ndërmejt me fisnikeve dhe trimave të tjerë të rinisë ishin kryetrimat, dy vëllezërit nga familja e lashtë e berishve, Dhimitër dhe Nikoll Berisha, ndihmën e të cilëve Skënderbeu e kishte të shënuar e të dendur (Marin Barleti, Historia e Skënderbeut, f.445). Për nder të heroit tonë Kombëtar, sapo u mbyll viti jubilar i 550 vjetorit të vdekjes së tij, Qeveria shqiptare e shpalli vitin 2018, viti i "Skënderbeut" gjatë të

- *Valët e këtij vullkani vazhdojnë të lekundin edhe sot trojet iliro arbnore të Kosovës Lindore (lugina e Preshevës, Medvegje, Bujanovc), Kosovës Veriore (Sanxhak), Iliridën, Çamërinë dhe trojet e malësisë së Tuzit e Ulqinit, të cilat rezistojnë, qëndrojnë e do të ftojnë*



nga Torenz Tocci - Torenz Toçi, Arbëresh i Italisë i titulluar Doktor i Shkencave Juridike. Ai erdhi në Shqipëri siç vetë do të i'u thoshte kryengritësve shqiptarë në vitin 1911 për të luftuar së bashku me ta dhe për ti shërbyer atdheut të të parëve të tij për pavarësinë e vendit. Natën e 12 prillit 1911 ai depërtoj nga Cetinja e Mali të Zi në Shqipëri duke kaluar nga Bjeshkët e Kelemdit, në Shalë, Toplanë e më tej përmes Berishës së Pukës i cili u mor në mbrojtje nga Ndoc Mark Deda e djelmënia e Malësisë, si dhe u shoqërua për të mbërritur në Fanë të Mirditës duke organizuar një kuvend i cili u mbështet nga viset e Shkodrës, Malsisë së Madhe, Pukës, Mirditës, Dibrës, Matit, etj., Në Mali të Zi ai kishte porositur edhe dy vula për Qeverinë e Përkohshme Shqiptare njerën në Milano dhe tjetrën në Trieste të Italisë. Kuvendi miratoi mosnjohjen e qeverisë turke, krijimin e Qeverisë së Përkohshme Shqiptare të kryesuar nga Torenz Toçi si Kryeministër, me synimin që në të ardhmen të bëhet Qeveri e Përhershme, si dhe miratoi programin e përbashkët të veprimt. Ky kuvend u përshëndet me breshëri armësh dhe u ngrit Flamuri Shqiptar që bashkë me ngritjen e tij me datë 06 prill 1911 në Deçiq të Tuzit nga Ded Gjon Luli përbëjn herën e parë të ngritjes së tij në trojet shqiptare pas vdekjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Me datën 27 Prill 1911 hartohet akti konstitutiv i Qeverisë së Përkohshme Shqiptare i cili nënshkruhet nga krerët pjesëmarrës. (Burimi: - Aurel Plasari, "Gazeta 55", "Si (nuk) u shpall pavarësia me 1911, Tiranë 10 shkurt 2007; Mark Mesuli, Një Kullë në histori "Qeveria e Kimzës "1911..Ngjarje e Pavarësisë. Tiranë 2007, f. 41-48; M. F. Bajraktari "Optimi i Shqipërisë dhe Kryengritja e Pukës 1911-1912", Canada 1967; Kol Dedaj, Në Panteonin e Lirisë, Tiranë 2018, f.85, 108).

Por kjo valë vullkanike e lirisë kombëtare ngjisur në shekuj dhe e pashuar asnjëherë do të gjente shpërthimin e saj me kryenngritjen mbarë kombëtare ku arkitektet e pavarësisë: Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi Isa Boletini, me në krye plakun e urtë e të mençur Ismail Qemali do ta kurorëzonin me shpalljen e pavarësisë më 28 Nëntor 1912.

Në përkujtim dhe nderim të figurave të ndritura Kombëtare, të vepres dhe veprimtarisë së tyre në shërbim të kombit, atdhetari modern Dodë Nikoll Luli, biri i Lum-Ziut të Pukës, i njohur në zhanerin e letrave shqipe me monografin "Dera e Përndocajve të Fanit", me kontributin e tij financiar dhe kërkesën e tij e protokolluar në Bashkinë Fushë-Arrës me nr.458prot., datë 11.02.2019, si dhe me mirëkuptimin e kësaj Bashkie dhe prekrashjen e saj të plotë, me miratimin në këshillin Bashkiak me vendimin nr.34 datë 20.03.2019, dhe konfirmimin nga prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.345/1prot., datë 08.04.2019, u bë e mundur ndërtimi i memorialit në qendër të qytetit të Fushë-Arrësit, të rrugëtimit të njeres prej valve të këtij vullkani të lirisë sonë kombëtare siç është ajo e krijimit të Qeverisë së Përkohshme Shqiptare më 27 Prill 1911 në Kimëz të Mirditës.

Në ceremoninë e përmirimit të këtij obelisku morën pjesë: Përfaqësues të Pushtetit lokal, akademik: Prof. Dr. Marenglen Verli-Rektor i Akademisë së studimeve Albanologjike, Prof. Dr. Beqir



Meta akademik i Institutit të historisë, studiues: Xhemal Meçi (Mjeshtër i Madh), Prof. Dr. Rexhep Uka, Dr. Mark Palnikaj, Mark Mesuli, Kol Dedaj, Pasardhës të Torenz Tocci-it, Dr. Terenzio D'Alema Tocci, Zef Ndoj pinjolli i Kullës së Pjeter Ndojit ku u formua qeveria në Kimëz, Selman Jashnica Lipjan Kosovë, biznesmeni Tonin Aliaj (Mjeshtër i Madh) dhe Lazër Mëhilli mbështetës dhe promovues të vlerave tona kombëtare, si dhe iniciuesi, finacuesin, bashkë organizuatori, Z. Dodë Nikoll Luli, si dhe intelektual, të afërm të firmëtarëve, të ftuar të shumtë dhe banorë të Fushë-Arrëzit, një ndër qytetet industriale më të zhvilluara të gjysmës së dytë të shekullit të XX në Shqipëri.

Fjalën e hapjes e mbajti Prof. Dr. Beqir Meta, dhe më tej u bë zbullimi i obeliskut nga Prof. Dr. Marenglen Verli, Dod Luli dhe nënkryetari i bashkisë Fushë Arrës Klement Sylja, pastaj u vazhdua me mbajtjen e kumesave nga Dr. Mark Palnikaj, Studiuesi Xhemal Meçi (Mjeshtër i Madh) i cili në kumtesën e tij cilësoi kontributin e rëndësishëm në këtë ngjarje të madhe të historisë sonë kombëtare që dha krahina e Pukës me firmetarë të aktit, Frrok Kola i Thaçit dhe Prend Uka i Berishës, si dhe ndihmen e çmuar në shoqërimin, mbrojtjen dhe sigurinë e Kryeministrit nga Ndoc Mark Deda i Berishes të cilit populli i këndoj në shekuj:

"N" at stamboll po këndon gazeta/ s'i nep armët Ndoc mark Deda/ Besa armet nuk i jap/ Për pa i la zaptit në gjak!/ Për pa i vra çato zapti/ Se këtu i thonë Pukë e Malësi !"

Te pranishmit i përshëndeten Prof. Dr. Rexhep Uka, si dhe pasardhësi i Torenz Tocci-it, Dr. Terenzio D'Alema Tocci i ardhur enkaz nga Roma-Itali, dhe pinjolli i Kullës së Zef Ndue Dodës ku u formua qeveria në Kimëz Pjeter Ndoj.

Këto valë lirie që nuk u shuanë kurrë në Kosovë në vitin 1999 sollën përmbushjen e ëndrrës shekullore kombëtare të lirisë së Kosovës e cila fitoj pavarësinë e saj, duke u rënditur si shteti më i ri në botë ndose një nga popujt më të lashtë të saj.

Por, valët e këtij vullkani vazhdojnë të lekundin edhe sot trojet iliro arbnore të Kosovës Lindore (lugina e Preshevës, Medvegje, Bujanovc), Kosovës Veriore (Sanxhak), Iliridën, Çamërinë dhe trojet e malësisë së Tuzit e Ulqinit, të cilat rezistojnë, qëndrojnë e do të ftojnë.



LIBRI


Rreth librit me poezi “Shqetësim zhgënjimi” të autorit Muharrem Kurti

DASHURIA PA LIRI MBETET FATPRERË

SHPENDI TOPOLLAJ

“Shqetësim zhgënjimi” titullohet libri me poezi i autorit gjakovar Muharrem Kurti, i cili pasi e lexova, ashtu si pa kuptuar më solli ndërmend thënien e drejtuesit të revistës letrare “Jeta e re”, Esad Mekulit, kur flet për stërnipat e Ali Binakut që për lirinë derdhën “djersë e gjak si etërit”. Vetë Esadi, i lindur në Plavën atdhetare, nuk arriti ta shohë lirinë e Kosovës, por Muharremi i lindur 47 vjet pas tij, pati rastin të përjetojë si shtypjen, arrogancën dhe pashpirtësinë kriminale të serbomëdhenjve, ashtu dhe dritën shkëlqimtare të lirisë. Natyrisht që ai lumturinë dhe kënaqësinë e tij për realizimin e ëndrrës më të madhe të vendit e popullit të tij e ka shprehur si në vargje, ashtu edhe në prozën e tij, pasi dihet se ai është njëkohësisht edhe autor tregimesh dhe romanesh. Nuk ka sesi të ngjasë tjetërsoj, kur ai e di mirë se roli i poetit është të ndjekë hap pas hapi kohën dhe rrugën nëpër të cilën ecën fati politik, social, ekonomik dhe shpirtëror i vendit të tij. Dhe kjo patjetër që nënkupton se ai do shohë detyrimish edhe mbrapa. Dhe ajo që ka mbetur pas, nuk mund të harrohet kurrë. Se atë nuk e harruan intelektualë të shquar jo shqiptarë, si fjala vjen Kërlezha në prozë apo malazezi tjetër Radovan Zogoviq, të cilët demaskuan me forcë projektet famëkëqia të Andriqit, Çubrilloviqit e Qosiqit me shokë. Por, krenaria e rezistencës, përpjekjeve, sakrificave, luftës apo dhe heroizmit në të shkuarën, dhe lumturimi nga shpërrja e shtypësit gjakatar, nuk është arsye që njeriu, dhe sidomos poeti të mbyllë sytë para të metave që shfaqen aty - këtu në shoqërinë e re demokratike që synohet të arrihet.

Fitimtarët, shpesh dehen nga euforia e suksesit. Ata gabojnë, dhe bijen në trysninë e pushtetit. Duke jetuar me lavdinë e luftës, ata komprometojnë paqen. Pikërisht kjo është dhe arsyeja që vjen zhgënjimi i njerëzve të thjeshtë. Revolta e tyre, shpesh e heshtur, brennda së cilës fshihet pakënaqësia, kërkon të shfaqet, por s’di nga të dalë. E gënjëjnë, duke i përsëritur se ai ka të drejtën e votës, dhe atje ta tregojë si simpatinë ashtu dhe antipatinë e tij. Por, e keqja është se atij i duhet të hedhë votën, po për ata. Si i tillë, ai mbetet përherë i pakënaqur. I pakënaqur dhe pa rrugëdalje, pra i dëshpëruar dhe i zhgënjyer. Dhe i zhgënjyer, në radhë të parë mbetet intelektual dhe sidomos poeti me zemrën e tij aq të ndjeshme dhe me shpirtin e tij kundërshtues. Nobelisti egjiptian Naghip Mahfuz (Naguib Mahfouz), në fjalën e tij me rastin e marrjes së titullit është shprehur se “E vërteta është që e keqja është një korruptuese e fuqishme dhe e dhunshme dhe që Njeriu kujton më shumë atë që dhemb se sa atë që gëzon.” Duke e ditur këtë të vërtetë, edhe Muharremi në poezitë e tij, nuk e fsheh indinjatën. Kështu, tek ajo me titull “Epigram për lapidarian”, ai thotë se është e padrejtë që para lapidarit të atij që dha jetën për Atdhe, të renditen edhe luftëtari i lirisë, edhe servili i robërisë, edhe kriminel i paqes. Dhe duke mos e përmbajtur zemërimin, u drejtohet ish të burgosurve politikë, atyre që dikur me



zërin e tyre kishin shpuar muret e trasha edhe pse ua kishin mbyllur gojën, dhe nga sytë që shpërndanin xixa zjarri, Kosova që ndezur cep më cep, me fjalët: “Në tokën e çliruar që po rilindte/ Liridashësit si lule në pranverë/ Mori fund lufta.../ O idealist të çeliktë/ Në duar të kujt e latë lirinë...” Me këtë dyshim ai sheh Gjakovën e tij, Kosovën, madje edhe Shqipërinë. Dhe ka të drejtë, pasi të njëjtat fenomene, si një mallkim i vetes, nuk u ndahen atyre. Ato ende vuajnë nga e njëjta ndarje, nga e njëjta joshje jo fort e ndershme e të huajve, nga klasa politike që më shumë mendon për xhepat e veta sesa për popullin, nga ata politikanë që kurrsesi nuk i lëshojnë karriget e tyre dhe nuk duan t’ja dinë për çmimin që atdheu paguan nga etja e tyre për pushtet.

Dhe kjo sipas poetit e ka një shpjegim; gjersa ai vëren se sot ferrat e kanë mbuluar truallin e shtëpisë së Fishtës ku “harresa e kuqe kullot atdheun”, dhe “Indiferenca e zezë nxin / Shikimet e bardha të vizitorëve”. Ndaj, dhe kur i drejtohet të madhit Din Mehmeti, që dikur buzëqeshte nga kafazi, tërheq vëmendjen: “Mos o Zot të harrojmë vetveten / Në zgrip të historisë.” Dhe jemi me të vërtetë në zgrip të historisë, për të cilin Ismail Kadareja ka thënë se “Kur koha punon për një popull, jo të gjithë e kanë të lehtë ta kuptojnë që koha punon për ta.” Të kuptuari e këtij momenti është shqetësimi i Muharrem Kurtit, i cili edhe tani që fizikisht na mungon, ka bindjen se bardi i madh nga Gjakova thërret: “Unë jam këtu te trualli i moçëm / Rojtar i atdheut dhe poezisë.” Sot, kur dinakërisht analet diplomatike

i ftojnë kosovarët të shtrohen në bisedime me agresorin serb, ka një kuptim të veçantë artikullimi i përcaktimit “Troje të moçme”. Shfletoja librin “Greqia përpara grekëve” të docentit francez në Fakultetin e Letrave të Dizhonit Luis Benloë (Louis Benloë) dhe ndihesha krenar që ky shkencëtar i paanshëm, arrinte në përfundimin se “Shqiptarët (janë) kombi më i vjetër i kontinentit”. E pra, a duhet ta lejojmë ne që ende sot të luhet me kufijtë tanë? Është tjetër gjë të tregohesh fisnik dhe ta lësh - siç thotë ky autor - derën hapur për fajtorin e penduar. Është njerëzore të kërkojë një jetë pa urrejtje dhe t’i thuash atij që të dogji, të vrau e të preu: “Dil nga çerdhja e krimit / Unë dola nga plagët e mia”. Dhe është krejt tjetër gjë, kur të shantazhojnë e të bëjnë presion për lëshime deri territori-ale (pa folur për dinjitetin), përkundrajt heqjes së vizave etj. Jo, nuk jemi ne që i kemi kujt ndonjë borxh. Përkundrazi, janë të tjerët, që si rezultat i pazareve të vjetra na detyrohen shumë e shumë ne shqiptarëve. Nuk jemi ne që meritojmë të ngrerë kokë emigrimi i detyruar për një jetesë më të mirë. Nuk janë nënat tona të urta ato që gjithë jetën duhet të presin duke u dridhur pranë oxhakut, djemtë e tyre. Fare mirë mund të jetojë si në Kosovë dhe në Shqipëri. Se me njerëzit ngjet ashtu si me gurët: “O gur pa emër e pa atdhe/ U dëboi dheu i huaj/ U mërdhin toka e huaj/ Pa peshe keni mbet/ Nga njeri cep në skajin tjetër/ “Të huaj” në vendin tuaj/ “I huaj” në dhe të huaj/ O gur pa emër e pa atdhe...”

Në vazhdim të kësaj teme që ky autor e trajton gjatë, dua të theksoj se dhim-

bja merr trajta dëshpërimi të thellë, kur lexon poezinë “Histori mërgimi”, ku poeti konstaton se edhe ata që ikin familjarisht po tjetërsohen, brezat po largohen nga malli për vendin e tyre, nga gjuha, nga zakonet e traditat, nga të afërmit, ku nipi nuk e merr më në telefon xhaxhanë. Ndaj ai shtron pyetjen e natyrshme, se kur dëgjojmë djemtë duke thënë Tanke dhe vajzat Aufiderzen “... nuk e din / kanë fituar apo humbur...” Para kësaj të vërtete rrëqethëse, poeti nuk mund të qëndrojë indiferent si shkëmbinjtë e bjeshkëve (shihni çfarë krahasimi tronditës).

Se poetit i qan zemra edhe nga padrejtësitë që bëhen në Korenë e Veriut apo në Siri nga fanatikët e ISIS - it, ku viktimat mbeten edhe fëmijët e pafajshëm të Alepos dhe Homsit. Zemra e tij nuk mund të heshtë para çdo gjëje jo njerëzore, kudo që të jetë ajo, pra atje ku nuk duan t’ja dinë se “Dielli nuk është /Lavdi Zotit/ Pronë e njeriut/ Atëherë pse disa diktatorë/ Ua ndalojnë të burgosurve/ Dritën e tij.” Ja pse ai shpërthen te poezia e tij plot patetizëm “Shqipërisë së ëndrrave dhe diktaturës”, ku sërish pyet: “Si mbijetoj atdhetari në zjarr / Të diktaturës pa u djeg?” E megjithatë edhe poeti kosovar Muharrem Kurti nuk mund t’i shpëtojë tundimit të dashurisë.

Aty ai bëhet tjetër njeri. Oskar ëajllidi ka përcaktuar bukur se “Dashuri është shumë më e lartë se arti.” Prandaj, duke ditur se atë nuk e shteruan as gjigantët e artit poetik, nuk po zgjatëm më tej, veçse po i mbyll këto shënime me bindjen e këtij poeti: “Fatkeqe e fatprerë / Dashuria pa liri.”

URIMI

Veteranët e OBVL, si të gjithë shqiptarët urojnë Arba Kokalarin: Shqipëria në Europë

Mbesa e Musine Kokalarit, eurodeputetja e parë shqiptare në Parlamentin European

Një shqiptare ulet për herë të parë në Parlamentin European. Ajo është Arba Kokalari, që jeton prej vitesh në Suedi. 32-vjeçarja shqiptare mori mbështetjen e suedezeve në zgjedhjet për parlamentin European që u zhvilluan ditën e diel. Kokalari është pjesë e partisë së Moderuar të Suedisë (Moderaterna).

“Unë kam hyrë në parlamentin evropian! Faleminderit për të gjithë ata që kanë luftuar për mua!” shkruante deputetja më e re e PE, Arba Kokalari në Facebook pas daljes së rezultateve. Partia ku bën pjesë edhe shqiptarja fitoi 17.6 % të votave të përkthyer në 4 deputetë në PE.

Por kush është ajo?

Arba Kokalari lindi në Tiranë më 27 nëntor 1986 dhe është mbesa e Musine Kokalarit, diplomuar në “La Sapienza” të Romës në vitin 1941, por që u dënua dhe internua më vonë nga regjimi komunist i Enver Hoxhës në Shqipëri dhe vdiq në 1983.

Arba Kokalari që 16-vjeçe nisi të



META: ARBA KOKALARI, I BËN TË LUMTUR TË GJITHË SHQIPTARËT

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka uruar Arba Kokalarin për zgjedhjen e saj si eurodeputete në Suedi. “Arba Kokalari, shqiptarja e parë eurodeputete, i bën të lumtur të gjithë shqiptarët dhe meriton mirënjohjen e tyre, jo vetëm si model suksesi në Suedi, por edhe përfaqësimi dinjitoz në Europën e Bashkuar”, shprehet Meta.

Lidhur me këtë arritje historike për shqiptarët ka reaguar dhe ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, i cili shprehet se, “Arba Kokalari do të jetë deputetja e parë shqiptare që ulet në Parlamentin European. Ajo është zgjedhur për të përfaqësuar Suedinë në PE, në zgjedhjet që u mbajtën dje”.

OBVL URON ARBA KOKALARIN PËR ZGJEDHJEN E SAJ SI EURODEPUTETJA E PARË SHQIPTARE

Veteranët e LANÇ dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të OBVL ndjehen krenarë dhe të lumtur me fitoren e Arba Koka-

larit si eurodeputetja e parë shqiptare. Kryesia e OBVL u shpreh mirënjohjen të gjithë bashkatdhetarëve tanë Suedi që me votën e tyre e mundësuan këtë moment historik.

“Ju urojmë për zemërsisht për këtë fitore historike. Ne krenohemi me Ju që jeni mbesa e disidentes antikomuniste Musine Kokalari, e cila u arrestua në vitin 1944, si themeluese e Partisë Social-Demokrate por edhe si një kundërshtarë e fortë e ideologjisë dhe regjimit diktatorial, sidomos me publicistikën e saj”, shkruan Kryesia e OBVL në msazhin e urimit.

Pas egzekutimit të dy vëllezërve, Musine Kokalari nisi një kalvar të gjatë gjyqesh politike të inskenuara dhe të montuara që e dënuan atë me 20 vite burg e mandej edhe me 22 vite internim. Pas këtij kalvari vuajtës në vitin 1981 asaj nuk iu dha e drejta nga autoritetet të kurohej prej kancerit në spital, dhe gjeti vdekjen në mjerim.

URIME ARBA KOKALARI!

Organizata e Gruas Shqiptare - Amerikane “Shpresë & Paqe” në SHBA, ndjehet tej mase e gëzuar për zgjedhjen në Parlamentin European të femrës së parë shqiptare Arba Kokalari, e cila përveç meritës së saj si politikanë e re njëherësh është edhe mbesë e intelektualës dhe Martires shqiptare Musine Kokalari.

Duke qenë se shumë nga anëtarët e organizatës tonë vijnë nga shtresa ish e persekutuar politike të Shqipërisë, ashtu si dhe familja e saj ndihemi krenarë për fitoren e Arba Kokalarit në këtë post të rëndësishëm, pasi ajo rrjedh nga një familje që ka përjetuar një genocid të rëndë nga komunizmi dhe diktatori Enver Hoxha.

Me këtë rast i dërgojmë Eurodeputetes se re urimet tona më të përzemërta dhe suksese të mëtejshme.

Organizata “Shpresë & Paqe”
Maj, 2019 - SHBA



merrej për herë të parë me politikë, ndërsa vitet e fundit ishte mjaft aktive në partinë e saj ku udhëhoqi rininë dhe departamentin e Kulturës në qytetin e Stokholmit, po ashtu edhe zëvendëse e kryetarit të shoqatës së EPP-së YEPP në maj 2015.

Pas fitores së arritur 32-vjeçarja shqiptare ka marrë shumë urime nga shqiptarët në mbarë botën, por edhe politikanët në Tiranë dhe Prishtinë. Pati disa kandidatë shqiptarë në zgjedhjet europiane në Belgjikë, Greqi, Itali dhe Suedi, por vetëm Kokalari arriti që të fitonte.

EURODEPUTETJA E PARË SHQIPTARE, ARBA KOKALARI ZGJIDHET NË SUEDI

Arba Kokalari, e cila jeton në Stokholm të Suedisë, është shqiptarja e parë që siguron një vend në Parlamentin European. Politikania e re është

it rinor të partisë në të cilën aderon, e ku ka qenë mjaft aktive. Ndër të parët që e përshëndetën një zhvillim të tillë ishte presidenti Ilir Meta. Pati mjaft kandidatë shqiptarë në zgjedhjet europiane këtë vit. Ata përfaqësuan Belgjikën, Greqinë, Italinë dhe Suedinë, e ishte pikërisht kjo e fundit që nxori edhe fituesen e vetme. Arba Kokalari është e afërme e shkrimtares së parë shqiptare, Musine Kokalari, që u diplomua në “La Sapienza” të Romës në vitin 1941, por u dënua më vonë në Shqipëri prej regjimit komunist e vdiq e internuar në Rrëshen në 1983-shin.

Vet eurodeputetja e re përcolli falenderime për mbështetësit e saj përmes një mesazhi në Facebook. “Moderatorët marrin një mandat të katërt dhe unë kam hyrë në Parlamentin European. Faleminderit për të gjithë ata që kanë luftuar për moderatorët dhe mua”, ka shkruar ajo

